

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5866
E shtunë, 31 gusht 2019
çmimi 0.40 €

**Ngritje të temperaturave,
deri në ngrirje
të thellë para zgjedhjeve
parlamentare!** | FAQE 10-11

Behxhet
Sh. SHALA -
BAJGORA



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE

**VENDET E QUINTIT KËRKOJNË NGA PARTITË POLITIKE TË MOS KANDIDOJNË PERSONA
ME TË KALUAR KRIMINALE NË ZGJEDHJET E PARAKOHSHME TË 6 TETORIT** | FAQE 4-5

Quinti: Zgjedhjet e 6 tetorit, vendimtare për qytetarët e Kosovës

Ambasadorët e vendeve të Quintit kanë vlerësuar se zgjedhjet e parakohshme të 6 tetorit janë mundësi vendimtare për qytetarët e Kosovës që të vendosin për drejtimin e shtetit. Ata kanë thënë se Kosova ka nevojë për

sundim të ligjit dhe se vetëm populli mund të sjellë ndryshime. Quinti ka kërkuar nga partitë politike të mos kandidojnë persona me të kaluar kriminale në këto zgjedhje. Po ashtu, ambasadorët e Quintit u kanë bërë

thirrje qytetarëve mos t'i votojnë kriminelët, por ata që mund ta luftojnë korrupsionin dhe krimin e organizuar. Sipas Quintit, zgjedhjet dhe qeveria e re ofrojnë mundësi për rifillimin urgjent të bisedimeve me Serbinë



**MINISTRAT E BE-së
DISKUTOJNË PËR
MARRËDHËNIET
KOSOVË-SERBI** | F. 2

**MBAHET PJESA E PARË
E TESTIT TË MATURËS,
AFATI I SHTATORIT** | F. 7

**LUAN LATIFI EMËROHET
KRYESHEF EKZEKUTIV
I KPM-së** | F. 3

EKONOMI



**DOGANA SHËNON 20-VJETORIN
E THEMELIMIT, MERR
VLERËSIME POZITIVE** | F. 8

**REÇICA NXJERR PËR
KONSULTIM PUBLIK
KONCEPTDOKUMENTIN PËR
SKEMËN E NDIHMËS SOCIALE** | F. 8

SPORT

**KAMPIONIA DHE
NËNKAMPIONIA KËRKOJNË
FITORE NË DERBI** | F. 16

**SHORT I LEHTË PËR UNITEDIN
DHE ARSENALIN** | F. 17

S'mund të ketë marrëveshje me Serbinë pa zbardhjen e fatit të të pagjeturve

 | FAQE 3

Liderët institucionale dhe ata politikë të Kosovës kanë vlerësuar se fati i të pagjeturve vazhdon të jetë plagë e hapur për shoqërinë e Kosovës. Në Ditën Ndërkombëtare të Personave të Pagjetur, ata kanë bërë me dije se nuk mund të ketë marrëveshje përfundimtare me Serbinë për sa kohë nuk zbardhet fati i të gjithë personave të zhdukur nga lufta e fundit në Kosovë

**Posti i kryeministrit
pamundëson
koalicinin
parazgjedhor
LDK - LV** | FAQE 5



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht-Tetovë
Curez-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Ministrat e BE-së diskutojnë për marrëdhëniet Kosovë-Serbi



Komisari i BE-së për fqinjësi dhe negocim të zgjerimit, Johannes Hahn, tha të premten në takim të ministrave të jashtëm të Bashkimit Evropian dhe atyre të Ballkanit Perëndimor, se Kosova duhet t'i heqë tarifën ndaj mallrave serbe dhe Serbia duhet t'i japë fund fushatës për çnjohjen e pavarësisë së Kosovës

PRISHTINË, 30 GUSHT - Në Helsinkë të Finlandës të premten është mbajtur takimi i ministrave të jashtëm të Bashkimit Evropian dhe atyre të Ballkanit Perëndimor. Në këtë takim ka dominuar tema për normalizimin e raporteve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Komisionari i Bashkimit Evropian për fqinjësi dhe negocim të zgjerimit, Johannes Hahn, tha të premten se Kosova duhet t'i heqë tarifën ndaj mallrave serbe dhe Serbia duhet t'i japë fund fushatës për çnjohjen e pavarësisë së Kosovës.

Ai i bëri këto komente në Helsinkë ku të premten ministrat e BE-së takuan ministrat e jashtëm të

vendeve të Ballkanit Perëndimor. Komisionari Hahn tha se rezultati i bisedimeve ndërmjet Serbisë dhe Kosovës është element thelbësor për ardhmërinë evropiane të rajonit. Ai shfaq shpresën se pas zgjedhjeve në Kosovë, që do të mbahen më 6 tetor, "gjërat do të jenë të më qarta" dhe më pas "të hyhet në negociatë përfundimtare".

Ai tha se Kosova duhet t'i heqë tarifën "që janë në kundërshtim me frymën e BE-së" dhe "Serbia duhet të përmbahet nga kjo nisma e tërheqjes së njohjeve të pavarësisë së Kosovës".

Bisedimet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë për normalizimin e mar-

rëdhënieve janë pezulluar që nga nëntori i vitit të kaluar kur Prishtina vendosi tarifa prej 100 për qind ndaj mallrave serbe, në kundërpërgjigje ndaj fushatës së Beogradi kundër shtetësisë së Kosovës.

Normalizimi i marrëdhënieve ndërmjet tyre është kusht për integritet evropian që janë aspiratë e të dyja vendeve.

Por, në Helsinkë të premten iu bë thirrje Serbisë që të mos largohet nga rruga e saj evropiane derisa Beogradi po përgatitet të nënshkruajë një marrëveshje tregtare me një bllok ekonomik të udhëhequr nga Rusia. Serbia pritet të nënshkruajë marrëveshjen me Bashkimin Ekonomik Euro-aziatik - të përbërë nga Rusia, Armenia, Bjellorusia, Kazakistan dhe Kirgizia në fund të muajit tetor.

Ministri i Jashtëm sllovak, Miroslav Lajčák, tha se nuk mund të ecet në disa drejtime njëherësh dhe Serbia duhet t'i harmonizojë politikën e saj me partnerët

evropianë.

"Nëse jeni serioz në orientimin evropian, atëherë merrni vendime që ju ofrojnë. Ky nuk është një prej tyre", tha Lajčák.

Shefja në largim e politikës së Jashtëme të Bashkimit Evropian, Federica Mogherini, tha se anëtarësimi i Ballkanit në Bashkimin Evropian nënkupton jo vetëm përfitime ekonomike por ndihmon edhe ndërtimin e paqes dhe ripajtimin.

"Mos të harrojmë se disa nga këto vende ishin në luftë vetëm 20 vjet më parë dhe kjo është një kohë e shkurtër. Vetëm perspektiva e të qenit së bashku në të njëjtën familje, në të njëjtin institucion, mund t'u japë atyre jo vetëm stimuj ekonomikë, por edhe stimuj institucionale, politike, për t'u pajtuar me një histori shumë të rëndë dhe të vështirë dhe për të parë drejt së ardhmes", tha ajo.

Por, Bashkimi Evropian është kritikuar për dështimin në përmirësimin e zotimeve duke zvarritur hapjen e negociatave për anë-

tarësim me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut. Bashkimi Evropian është shprehur i përkushtuar për ta bërë këtë në tetor, por Mogherini tha se vendet anëtare ende nuk janë gati për një vendim të tillë.

Serbia hapi këto negociata në vitin 2014 por procesi varet nga marrëdhëniet me Kosovën, pavarësinë e së cilës vazhdon ta kundërshtojë. Beogradi madje reagoi edhe ndaj pjesëmarrjes së Kosovës në takimin në Helsinkë.

Hapja e negociatave Serbisë asaj i ishte mundësuar me marrëveshjet me Kosovën të vitit 2013 të cilat Kosovës i siguruan Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit me Bashkimin Evropian.

Megjithatë ajo mbetet e fundit në proceset integruese dhe qytetarët e saj janë të vetmit në rajon që nuk mund të lëvizin pa viza, ndonëse siç tha të premten zënjë Mogherini, Kosova i ka plotësuar të gjitha kriteret për përfshirjen në regjimin e udhëtimit pa viza. (voa).

Parlamenti shqiptar i rikthehet punës më 2 shtator

Tiranë, 30 gusht - Pas më shumë se një muaji pushime, Kuvendi do të nisë sesionin e ri parlamentar të hënën e parë të shtatorit. Përmes një njoftimi, Kuvendi sqaron se seanca e parë plenare të sesionit V do të mbahet të hënën e 2 shtatorit, në orën

18:00.

"Bazuar në nenin 74, pika 1 të Kushtetutës, në nenin 42, pika 1 të Rregullores së Kuvendit dhe në Urdhërin nr. 26, datë 29.8.2019 të kryetarit të Kuvendit, Gramoz Ruçi, të hënën e parë të shtatorit, më datë 2.9.2019, në orën 18.00

do të fillojnë në seancë plenare punimet e Kuvendit në sesionin V", thuhet në njoftim, duke cekur edhe rendin e ditës të kësaj seance.

Ndërkohë, edhe ky sesion parlamentar do të nisë pa praninë e opozitës, e cila ka djegur man-

datet, duke kërkuar largimin e kryeministrit Edi Rama. Në vend të deputetëve të ligjshëm të opozitës janë një grup deputetësh të ardhur nga listat që votojnë çdo ligj të qeverisë dhe sulmojnë opozitën reale jashtë Kuvendit.



Kosova ka shënuar Ditën Ndërkombëtare të Personave të Pagjetur

S'mund të ketë marrëveshje me Serbinë pa zbardhjen e fatit të të pagjeturve

Liderët institucionalë dhe ata politikë të Kosovës kanë vlerësuar se fati i të pagjeturve vazhdon të jetë plagë e hapur për shoqërinë e Kosovës. Në Ditën Ndërkombëtare të Personave të Pagjetur, ata kanë bërë me dije se nuk mund të ketë marrëveshje përfundimtare me Serbinë për sa kohë nuk zbardhet fati i të gjithë personave të zhdukur nga lufta e fundit në Kosovë



EPOKA E RE Muhamet KOCI

PRISHTINË, 30 GUSHT - Në Ditën Ndërkombëtare të Personave të Pagjetur është organizuar një ecje sensibilizuese, e cila kishte për qëllim adresimin e zbardhjes së fatit të personave të pagjetur të luftës së fundit në Kosovë. Me këtë rast, përfaqësuesit e shoqatave të personave të pagjetur kanë kërkuar më shumë angazhim të institucioneve për zbardhjen e fatit të këtyre personave.

Këtë ditë e kanë përkujtuar edhe liderët institucionalë dhe ata politikë të Kosovës, të cilët kanë vlerësuar se fati i të pagjeturve vazhdon të jetë plagë e hapur për shoqërinë e Kosovës. Ata kanë bërë me dije se nuk mund të ketë marrëveshje përfundimtare me Serbinë për sa kohë nuk zbardhet fati i të gjithë personave të zhdukur nga lufta e fundit në Kosovë. Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë se zbardhja e fatit të të pagjeturve është jetike për familjet tona dhe për Republikën e Kosovës, për të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen tonë. "Në këtë ditë ndërkombëtare kërkojmë nga institucionet ndërkombëtare që të bëjnë më shumë për zbardhjen e fatit të të pagjeturve tanë. Nuk mund të ketë paqe pa e zbardhur

të vërtetën e fatit të tyre dhe pa dhënë përgjegjësi kryesit e krimeve. Nuk do të ndalemi deri në zbardhjen e fatit të çdo të pagjeturi në Kosovë. As ne dhe as bashkësia ndërkombëtare nuk mund të lejojmë që gjenocidi serb në Kosovë të harrohet dhe të kalojë i pandëshkuar", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook". Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) me këtë rast ka thënë se edhe pse kanë kaluar 20 vjet nga lufta, të zhdukurit vazhdojnë të jenë plagë e hapur për shoqërinë tonë. "Sot shënohet Dita Ndërkombëtare e të Zhdukurve. Edhe pse kanë kaluar 20 vjet nga lufta kjo plagë e hapur, ende e rëndon shoqërinë tonë, duke shkaktuar dhimbje të pandalshme të familjet e pothuajse 1 700 qytetarëve. Shpreh solidaritetin ndaj familjarëve të të pagjeturve, të cilët për më shumë se dy dekada jetojnë në makth duke kërkuar që të mësojnë çka ka ndodhur me të afërmit e tyre. Me këtë rast bëj sërish thirrje të mekanizmat ndërkombëtarë dhe Bashkimi Evropian, që të bëjnë presion ndaj Beogradit për ta zbardhur fatin e të pagjeturve të

Kosovës dhe për të vendosur para ligjit kriminelët përgjegjës", ka shkruar Veseli në llogarinë e vet në "Facebook".

Kurse kryeministri në detyrë, Ramush Haradinaj, ka thënë se është obligim i institucioneve shtetërore që të punojnë përditë, pa u ndalur, që ta zbardhin fatin e të pagjeturve. "Të zhdukurit e luftës janë plaga jonë më e madhe që na përcjellë secilën ditë, tash e dy dekada. Sot në nderim të tyre mora pjesë në ecjen solidarizuese dhe bëra homazhe te Obelisku i të pagjeturve të luftës, me rastin e Ditës Ndërkombëtare të të Zhdukurve. Është obligim yni shtetëror që të punojmë përditë, pa u ndalur, që ta zbardhim fatin e tyre. Kosova nuk harron", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Homazhe tek obelisku i të pagjeturve të luftës ka bërë edhe kandidatja e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) për kryeministre, Vjosa Osmani, e cila ka thënë se nuk mund të ketë normalizim të raporteve me Serbinë pa u mbyllur çështje e të pagjeturve. "Sot e çdo ditë, e themi para gjithë botës, se nuk do të ketë qetësi dhe se përp-

jekjet për normalizim raportesh me Serbinë nuk mund të japin asnjë rezultat derisa plagët në zemrat e nënave tona të jenë të hapura; nuk mund të ketë paqe të vërtetë ndërmjet nesh pa paqe shpirtërore të secila familje në Kosovë, që edhe 20 vjet pas luftës, kanë familjarë të zhdukur", ka shkruar Osmani në llogarinë e vet në "Facebook".

Në Ditën Ndërkombëtare për Personat e Zhdukur, kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, bashkë me ish-deputetë, anëtarë të kryesisë dhe aktivistë të kësaj lëvizjeje kanë bërë homazhe në Sheshin "Skënderbeu" para përmendores dedikuar të pagjeturve të luftës. "Prej luftës së fundit në Kosovë fati i 1 652 të pagjeturve ende mbahet peng në errësirat e zyrave të shtetit serb. Familjarët e tyre ende kërkojnë të vërtetën dhe drejtësinë për ta. Fati i të pagjeturve është ngushtësisht i lidhur me fatin tonë, të mos kërkojmë drejtësi për ta do të thotë ta zhdukësh veten prej drejtësisë. Paqja, ardhmëria dhe zhvillimi nuk e mbushin kurrë boshin dhe mungesën e tyre. Brenga për të pagjeturit na mëson se paqen në

jetë e sjell vetëm vendosja e drejtësisë", është thënë në njoftimin e Vetëvendosjes.

Ndërsa kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, në Ditën Ndërkombëtare të Personave të Pagjetur ka sjellë në kujtesë se në çfarë dhimbjesh ka kaluar Kosova për të ardhur deri te liria. "Sot, në Ditën Ndërkombëtare të Personave të Pagjetur, sjellim në kujtesë se në çfarë dhimbjesh ka kaluar vendi për të ardhur deri te liria. Sot rikonfirmojmë vendosmërinë tonë si shtet se nuk do të lëmë gurë pa lëvizur deri në zbardhjen e fatit të të gjithë personave të zhdukur. Çështja e personave të zhdukur është plagë e cila rëndon mbi shoqërinë tonë tash e 20 vjet dhe se nuk mund të ketë marrëveshje përfundimtare me Serbinë për sa kohë nuk zbardhet fati i të gjithë personave të zhdukur nga lufta e fundit në Kosovë. Kosova dhe institucionet e saj nuk do të ndalen së kërkuari asnjëherë drejtësi për të gjithë personat e pagjetur", ka shkruar Limaj në llogarinë e vet në "Facebook". Kosova numëron mbi 1 600 persona të zhdukur gjatë luftës në Kosovës.

Luan Latifi emërohet kryeshef ekzekutiv i KPM-së



PRISHTINË, 30 GUSHT (ER) - Komisioni i Pavarrur i Mediave, në mbledhjen e mbajtur më 29 gusht, me votim unanimit nga të gjithë anëtarët dhe në pajtim me nenin 18 të Ligjit Nr. 04/L-44, e ka emëruar Luan Latifin kryeshef ekzekutiv i KPM-së. "Vendimi për emërimin

e z. Latifi për kryeshef ekzekutiv është marrë duke u bazuar në rezultatet e arritura në konkursin publik për pozitën Kryeshef Ekzekutiv i KPM-së, i organizuar nga Ministria e Administratës Publike (MAP). Luan Latifi është i lindur më 2 nëntor 1975 në Gjilan.

Studimet themelore i ka përfunduar në Prishtinë, Fakulteti Filozofik - Drejtimin Sociologji, ndërsa studimet Master i ka përfunduar në Gazetari, në Institutin Kosovar për Gazetari dhe Komunikim (KIJAC)", është bërë me dije në njoftimin e KPM-së.



Vendet e Quintit kërkojnë nga partitë politike të mos kandidojnë persona me të kaluar kriminale në zgjedhjet e parakohshme të 6 tetorit

QUINTI: ZGJEDHJET E 6 TETORIT, VENDIMTARE PËR QYTETARËT E KOSOVËS

Ambasadorët e vendeve të Quintit kanë vlerësuar se zgjedhjet e parakohshme të 6 tetorit janë mundësi vendimtare për qytetarët e Kosovës që të vendosin për drejtimin e shtetit. Ata kanë thënë se Kosova ka nevojë për sundim të ligjit dhe se vetëm populli mund të sjellë ndryshime. Quinti ka kërkuar nga partitë politike të mos kandidojnë persona me të kaluar kriminale në këto zgjedhje. Po ashtu, ambasadorët e Quintit u kanë bërë thirrje qytetarëve mos t'i votojnë kriminelët, por ata që mund ta luftojnë korrupsionin dhe krimin e organizuar. Sipas Quintit, zgjedhjet dhe qeveria e re ofrojnë mundësi për rifillimin urgjent të bisedimeve me Serbinë

**EPOKA
ERE**

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 30 GUSHT - Ambasadori i Francës, i Gjermanisë, i Italisë, i Mbretërisë së Bashkuar dhe i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, nëpërmjet një deklaratë të përbashkët për medie, kanë kërkuar nga partitë politike të mos kandidojnë persona me të kaluar kriminale në zgjedhjet e parakohshme të 6 tetorit.

Quinti u ka bërë thirrje qytetarëve që mos t'i votojnë kriminelët, por

ata që mund ta luftojnë korrupsionin dhe krimin e organizuar. "Ç'është më e rëndësishmja, Kosova ka nevojë për sundim të ligjit. Besojmë se kandidatët duhet të mos kenë të kaluar kriminale, apo lidhje me veprimtari kriminale, dhe se duhet të tregojnë se si ata do ta luftojnë korrupsionin dhe krimin e organizuar, si do të kundërshtojnë pandëshkueshmërinë dhe nepotizmin në nivelet më të larta, dhe si do të bëjnë qeverisje të pastër përmes emërimeve të bazuara në meritë dhe politikat dhe programet që shpërblejnë

integritetin. Mundësia e parë që partitë t'i shfaqin këto përkushime është duke përpiluar lista të kandidatëve që kanë për prioritet kompetencën, jo lidhjet. Pra, nga sot e deri në ditën e zgjedhjeve, flisni hapur- thojuni partive dhe kandidatëve atë që prisni nga qeveria e ardhshme. Këmbëngulni që të kenë plane dhe propozime reale, jo vetëm retorikë të zbrazët. Gjykoni nëse njerëzit për të cilët keni votuar do t'i përmbushin premtimet e tyre. Refuzojini kriminelët. Kërkoni përzgjedhje të vërtetë demokratike. Dhe në ditën

e zgjedhjeve dilni dhe votoni", është thënë në deklaratën e Quintit.

Ambasadorët e Quintit kanë vlerësuar se zgjedhjet e ardhshme janë mundësi vendimtare për qytetarët e Kosovës që të vendosin për drejtimin e shtetit. Sipas tyre, vetëm populli mund të sjellë ndryshime. "Qeveritë tona dëshirojnë që Kosova, e cila tash gjendet në dekadën e dytë të ekzistimit, të ketë sukses. Ne do të vazhdojmë ta përkrahim zhvillimin e saj. Por, përgjegjësi për të ardhmen e Kosovës, për udhëheqësit e Kosovës dhe për vetë Kosovën, është vetëm e juaja, e popullit të Kosovës. Ky është shteti juaj. Falë shumë atyre që kanë luftuar dhe sakrifikuar, vendi juaj është një demokraci. Sikurse edhe demokracia në shtetet e tjera, përfshirë shtetet tona, sistemi i Kosovës ka papërsosmëri. Zërat dhe votat tuaja janë të rëndësishme. Vetëm populli mund të sjellë ndryshime. Zgjedhjet e

ardhshme janë mundësi vendimtare për qytetarët e Kosovës që të vendosin për drejtimin e shtetit. Qytetarët e Kosovës meritojnë premtim për të ardhme paqësore dhe të begatë dhe e vetmja rrugë për të siguruar këtë të ardhme është përmes shprehjes së vullnetit të popullit në këto zgjedhje", është theksuar në këtë deklaratë. Sipas Quintit, nga këto zgjedhje Kosova ka nevojë për udhëheqës me ide të detajuara për atë se si të përmbushen kërkesat e qytetarëve dhe për një qeveri që mund të punojë me kredibilitet. "Ju nxisim që të ngriheni mbi retorikën populiste dhe nacionaliste që nuk do t'i ndihmojnë Kosovës. Qytetarët e Kosovës meritojnë të dëgjojnë platforma të detajuara nga partitë, në mënyrë që të marrin vendime të arsyeshme për votën e tyre. Votuesit meritojnë përgjigje të detajuara nga partitë për atë se si programet e tyre do ta forcojnë sistemin e arsimit ashtu që të



raportet e vitit 2017 të Misionit të BE-së për Vëzhgimin e Zgjedhjeve). Ne refuzojmë tryshinë ndaj votuesve, duke përfshirë kërcënimet për punë, blerjen e votës, përfshirë atë përmes premtimit të posteve publike. Ne refuzojmë çfarëdo sulmi ndaj medimeve, qoftë ai fizik apo në formë të thirrjes për dhunë dhe refuzojmë tentimet për t'i etiketuar mediumet me 'lajme të rreme'. Ne qëndrojmë pranë medimeve të pavarura dhe shoqërisë civile në ushtrimin e roleve të tyre të monitorimit dhe vëzhgimit publik të procesit zgjedhor", është theksuar në deklaratë.

Vendet e Quintit inkurajojnë qytetarët që t'i lajmërojnë abuzimet e fondeve apo resurseve publike në fushatë si dhe çdo përpjekje për frikësim. "Ne presim nga autoritetet e Kosovës që të ndërmarin veprime të shpejta dhe të duhura ndaj të gjitha shkeljeve në tërë shtetin. Për të ardhmen demokratike të Kosovës është me rëndësi që të gjithë ata që janë të përfshirë t'i respektojnë ligjet zgjedhore të shtetit dhe që zgjedhjet të zhvillohen siç është paraparë më 6 tetor", është thënë, ndër të tjera, në deklaratën e Quintit.

ZGJEDHJET DHE QEVERIA E RE OFROJNË MUNDËSI PËR RIFILLIMIN E BISEDIMEVE ME SERBINË

Ambasadorët e vendeve të Quintit kanë thënë se zgjedhjet e 6 tetorit dhe formimi i qeverisë së re ofrojnë mundësi për rifillimin e dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë. Ata kanë vlerësuar se arritja e një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse është në interes të Kosovës si dhe i kontribuon stabilitetit rajonal. "Siç edhe vënë në dukje qeveritë tona së fundmi, zgjedhjet dhe formimi i qeverisë së re ofrojnë një mundësi për rifillimin urgjent të bisedimeve me Serbinë me qëllim të arritjes së një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse, politikisht të qëndrueshme dhe ligjrisht të obligueshme, që i kontribuon stabilitetit rajonal. Kjo qartësisht është në interesin e Kosovës. Për të arritur një marrëveshje qeveria e ardhshme e Kosovës do të ketë nevojë për fleksibilitet për të negociuar dhe aftësi për të artikuluar një vizion pozitiv për marrëdhënien e ardhshme të shtetit me Serbinë dhe dobite ekonomike dhe të sigurisë që ajo mund t'i sjellë Kosovës", është theksuar në deklaratën e Quintit.

diplomuarit të jenë më mirë të përgatitur për punësim, se si ato programe do të krijojnë vende pune dhe si do ta përmirësojnë zhvillimin e sektorit privat dhe investimet, si do ta përkrahin ndërmarrësinë, si do ta mbajnë përgjegjësinë fiskale dhe si do ta përmirësojnë sigurinë e furnizimit me energji dhe mjedisin. Ne përfaqësojmë shtetet që janë thellësisht të përkushtuara ndaj Kosovës demokratike dhe të pavarur. Çdo sugjerim se qeveritë tona përkrahin ndonjë parti apo kandidat të veçantë në zgjedhje është i pasaktë. Sikurse në zgjedhjet e kaluara, ne do të bashkoemi me organet e tjera lokale dhe ndërkombëtare për të ndihmuar që të sigurohet një ambient i lirë dhe i drejtë", është theksuar më tutje në deklaratën e Quintit.

Ambasadori i Francës, i Gjermanisë, i Italisë, i Britanisë dhe i Amerikës kanë vlerësuar se Kosova në të kaluarën ka dëshmuar përvojë në mbajtjen e zgjedhjeve të besueshme dhe të menaxhuara në mënyrë profesionale, edhe pse jo të përkryera. Quinti pret nga të gjitha partitë politike dhe kandidatët që të promovojnë një ambient të drejtë të garës zgjedhore në tërë Kosovën. "Ambasadat tona presin që këto zgjedhje të kenë përmirësime krahasuar me zgjedhjet e kaluara dhe që të shmangen nga manipulimet dhe mashtrimet që njollosën zgjedhjet e vitit 2010 (siç e thotë raporti i 2010-s i Misionit të BE-së i Ekspertëve Zgjedhore), si dhe frikësimi i kandidatëve dhe votuesve serbë të Kosovës që nuk ishin të rreshtuar me Listën Serbe në vitin 2017 (të përmendur në

Dështon arritja e koalicionit në mes të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK-së) dhe Lëvizjes Vetëvendosje (LV-së)

Posti i kryeministrit pamundëson koalicionin parazgjedhor LDK - LV

Pavarësisht prej përpjekjeve, as të premtën nuk është arritur koalicioni parazgjedhor në mes të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) dhe Lëvizjes Vetëvendosje. Isa Mustafa nuk e ka pranuar ofertën e Albin Kurtit që këto dy parti të garojnë me një listë të përbashkët në zgjedhjet e parakohshme të 6 tetorit. Oferta e Kurtit ka paraparë që kandidatja e LDK-së për kryeministër, Vjosa Osmani, të jetë numër një në listë, kurse pas saj kandidati i Vetëvendosjes për kryeministër, ndërkaq ai kandidat që do të merrte më shumë vota do të bëhej kryeministër

**EPOKA
ERE**

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 30 GUSHT - Në kuadër të përpjekjeve për arritjen e koalicionit parazgjedhor në mes të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) dhe Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Albin Kurti të premtën ia ka ofruar Isa Mustafës shansin e fundit që këto dy subjekte politike të garojnë me një listë të përbashkët në zgjedhjet e parakohshme të 6 tetorit. Por, kjo ofertë është refuzuar nga lideri i LDK-së, Isa Mustafa.

Oferta e Kurtit ka paraparë që kandidatja e LDK-së për kryeministër, Vjosa Osmani, të jetë numër një në listë, kurse pas saj kandidati i Vetëvendosjes për kryeministër, ndërkaq ai kandidat që do të merrte më shumë vota do të bëhej kryeministër. "Sot, duke pasur parasysh shansin unik, për të hapur një kapitull të ri për shtetin tonë, propozojmë një alternativë të re për koalicionin tonë. Le të garojmë me një listë të përbashkët si LDK dhe LVV, pa kandidat të paradhënë e të njëanshëm për kryeministër, por le të bëhet ajo ose ai që fiton më së shumti vota në zgjedhjet e 6 tetorit 2019. Pra, znj. Vjosa Osmani, ose kandidati ynë i

Lëvizjes Vetëvendosje!, varësisht cili merr më shumë vota. Me këtë rast ne shprehim gatishmëri për një koncesion të madh: në listën zgjedhore nr. 1 të jetë znj. Vjosa Osmani, kurse nr. 2 kandidati ynë të cilin e vendos Këshilli ynë i Përgjithshëm (e të cilin, për hir të korrektësisë ndaj bisedimeve tona, ne ende nuk e kemi mbajtur). Numri 1 në listën garuese është bartës liste, kurse numri 2 është përfaqësues i koalicionit", ka shkruar Kurti në llogarinë e vet në "Facebook".

Ofertës së Kurtit për koalicion parazgjedhor i është përgjigjur lideri i LDK-së, Isa Mustafa. Në letrën drejtuar Kurtit, Mustafa ka vlerësuar se LDK-ja është e hapur të bëjë koalicion me LV-në vetëm me Vjosa Osmanin kandidatë të përbashkët për kryeministër. Sipas Mustafës, oferta e Kurtit me një listë, pa një prijës të nominuar, është një listë pa krye dhe pa orientim të qartë. "Gjatë muajve, javëve dhe ditëve të fundit, LDK-ja ka punuar shumë dhe hapur, për të arritur një marrëveshje bashkëpunimi me LV-në, me qëllim që të lidhim koalicion parazgjedhor dhe për të garuar së bashku më 6 tetor. LDK-ja me kohë e ka bërë të ditur se një dhe e vlerëson pritshtësinë e qyte-

tarëve të Kosovës për këtë bashkëpunim. LDK-ja është e hapur që marrëveshja të lidhet, nën drejtimin e kandidatës sonë për kryeministër, znj. Vjosa Osmani. Këshilli i Përgjithshëm i LDK-së e ka miratuar unanimisht kandidaturën e znj. Osmani, prandaj ajo e ka përkrahjen e plotë të LDK-së për ta kryesuar listën si kandidatë për kryeministër dhe për t'i fituar zgjedhjet. LDK-ja është subjekti më i madh politik në Kosovë, ka besimin më të madh, ka përkrahjen më të madhe, prandaj edhe do ta udhëheqë vendin", ka shkruar Mustafa në llogarinë e vet në "Facebook".

Ai ka thënë se propozimi i Kurtit shpie nga gara me të tjerët, në garë ndërmjet LDK-së dhe LV-së dhe, sipas Mustafës, kjo do ta dëmtonte seriozisht interesin e përbashkët. "Po ashtu, LDK-ja vlerëson se një listë pa një prijës të nominuar është një listë pa krye dhe pa orientim të qartë. LDK-ja shpreh gatishmërinë e plotë që ta vijojë bashkëpunimin me LV-në, tani apo dhe pas zgjedhjeve dhe e konsideron atë si partnere në kauzën për ta shpëtuar vendin nga krimi, korrupsioni, zhvatja dhe për ta nxjerrë vendin nga izolimi", ka deklaruar Mustafa.



24-vjeçari dënohet me gjashtë muaj burgim për propagandë të IS-it

PRISHTINË, 30 GUSHT - Gjykata Themelore në Prishtinë ka dënuar 24-vjeçarën Berat Qamili me gjashtë muaj burgim për shpërndarje të materialeve që përkrahin grupin militant, Shteti Islamik (IS), në rrjetet sociale. "Sot është bërë shpallja e akt-gjykimit dhe Gjykata e shpalli të fajshëm klientin tim duke e dënuar me gjashtë muaj burg

efektiv", ka thënë avokati Gazmend Ismajli për "Radion Evropa e Lirë".

Aktakuza ndaj Qamilit nga rrethi i Mitrovicës është ngritur në janar të vitit 2018 nën dyshimin se ka kryer veprën penale "bashkim ose pjesëmarrje në ushtrinë apo policinë e huaj, në formacionet e jashtme paraushtarake apo parapolicore,

në organizimet grupore ose individualisht jashtë territorit të Republikës së Kosovës".

Avokati Ismajli ka thënë se klienti i tij e kishte pranuar fajësinë dhe me këtë rast Gjykata ka marrë për bazë rrethanat lehtësuese. Qamili ishte arrestuar në 2017-n dhe më pas i ishte caktuar masa e arrestit shtëpiak prej tre muajve.



Lladrovci kërkon që të merren masa për sigurinë publike në Drenas

DRENAS, 30 GUSHT (ER) - Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi në Komunën e Drenasit ka mbajtur mbledhjen e rregullt ku të pranishëm ishin anëtarët e KKS-së, monitorues nga misioni i OSBE-së, KFOR-it dhe UNMIK-ut.

Në këtë takim u fol për përgatitjet e Drejtorisë Komunale të Arsimit (DKA) dhe Stacionit Policor për parandalimin e dukurive negative për vitin shkollor 2019/2020. Gjithashtu, u raportua për aktivitetet gjatë "Muajit të Mërgatës" dhe u diskutua për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 6 tetorit.

Florim Gecaj ka folur për përgatitjet e vitit shkollor 2019/2020, duke theksuar se policia ka bërë plane konkrete

për sigurinë në shkolla dhe në komunikacion.

Nënkryetari i komunës, Nazmi Hasi, ka kërkuar që të bashkëpunojnë me Stacionin Policor në Drenas, me Drejtorinë Komunale të Arsimit dhe me drejtorë të shkollave për ta ruajtur sigurinë publike në institucionet arsimore. Ndërsa drejtori i DKA-së, Tafil Halilaj, ka treguar se janë bërë të gjitha përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor, gjithashtu kanë pasur takim edhe me Asociacionin e Komunave për t'i parandaluar dukuritë negative.

Në pikën për raportimin mbi "Muajin e Mërgatës", ka raportuar drejtoresha për Kulturë, Rini dhe Sport, Shqipe Zogu, e cila ka treguar detajet e shënimit të këtij



eventi i cili tanimë është bërë tradicional.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, ka kërkuar nga Komisioni Komunal Zgjedhor,

Stacioni Policor në Drenas dhe nga të gjithë aktorët e tjerë, që të ndërmarrin masat me kohë për të mos pasur probleme të natyrës që dëmtojnë procesin e

zgjedhjeve dhe sigurisë publike, siç ka ndodhur në zgjedhjet e fundit lokale dhe policia nuk i ka marrë masat e duhura për rastet e raportuara.

Buxheti i Komunës së Ferizajt për vitin 2020 do të jetë mbi 36 milionë euro



FERIZAJ, 30 GUSHT (ER) - Komuna e Ferizajt, pas analizës dhe imputeve të marra nga dëgjimet buxhetore me qytetarë, ka përgatitur buxhetin për vitin 2020. Këtë dokument, sipas afatit ligjor, drejtoresha e Drejtorisë së Financave, Sebahate Ajeti-Sadiku, ia ka dorëzuar të premtën kryesueses së Kuvendit të Komunal të Ferizajt, Kristina Gashi-Bytyçi, që në seancën e radhës të aprovohet nga anëtarët e Kuvendit.

Buxheti i kësaj komune për vitin 2020 do të jetë 36 milionë

e 23 mijë e 634 euro. Sipas Komunës së Ferizajt, ky buxhet do të jetë zhvillimor dhe i bazuar krejtësisht në rritjen e shërbimeve dhe kualitetit të jetës së qytetarëve. "Ndër projektet kapitale në kuadër të këtij buxheti janë përfshirë edhe një numër projektesh unike që pritet të realizohen për herë të parë në territorin e Ferizajt. Këto risi dhe projeksione buxhetore rrisin cilësinë e jetës së ferizajasve duke e kthyer Komunën e Ferizajt drejt orientimeve strategjike-investimore për vitin 2020", ka njoftuar Komuna e Ferizajt.

Kuvendi Komunal i Rahovecit aprovon tri vendime

RAHOVEC, 30 GUSHT (ER) - Kuvendi Komunal i Rahovecit ka mbajtur mbledhjen e tetë të rregullt, në të cilën janë aprovuar disa vendime, ai për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim afatshkurtër personave fizikë dhe juridikë, vendimi për nismën e bashkëpunimit komunal ndërkombëtar për binjakëzimin midis Komunës së Rahovecit dhe Komunës Civita. Në këtë mbledhje është aprovuar edhe propozimi i kryetarit të komunës për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale.

Rahovecit dhe Komunës së Frascineto dhe vendimi për nismën e bashkëpunimit komunal ndërkombëtar për binjakëzimin midis Komunës së Rahovecit dhe Komunës Civita. Në këtë mbledhje është aprovuar edhe propozimi i kryetarit të komunës për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale.

Kuvendarët kanë aprovuar Rregulloren Komunale për Transparencë Komunale Nr. 03/2019.

Po në këtë mbledhje nga drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Përparim Krasniqi, është dhënë një informatë mbi zbatimin e planit për investime në hapësirat e hapura publike në Komunën e Rahovecit.



Inspektohen punimet për ndërtimin e Spitalit të Përgjithshëm në Ferizaj

Ministri Ismaili: Spitali modern i Ferizajt, i gatshëm vitin tjetër

Ministri në detyrë i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka vizituar të premtën vendpunimin ku është duke u ndërtuar spitali i ri i këtij qyteti. Gjatë kësaj vizite ministri Ismaili ka thënë se Ferizajt po i korrigohet një padrejtësi shumëvjeçare për ta pasur një spital modern që u përgjigjet kërkesave të qytetarëve. Ai ka thënë se ky spital do të jetë i gatshëm vitin e ardhshëm

**EPOKA
ERE** **Faton DËRMAKU**

FERIZAJ, 30 GUSHT - Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës, dr. Basri Sejdiu, i shoqëruar nga ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili dhe nga kryetari i Komunës së Ferizajt, Agim Aliu, kanë vizituar të premtën vendpunimin ku është duke u ndërtuar spitali i ri i këtij qyteti.

Gjatë kësaj vizite u vlerësua se Ferizajt po i korrigohet një padrejtësi shumëvjeçare për ta pasur një spital modern që u përgjigjet kërkesave të qytetarëve. "Jam shumë i lumtur që po shoh edhe nga afër se punimet për ndërtimin e Spitalit të Ferizajt kanë avancuar shumë. Ky do të jetë një

nga spitalet më moderne në Kosovë. Duke parë dinamikën e punimeve, ne besojmë se ky spital do të jetë i gatshëm për qytetarët vitin e ardhshëm", ka thënë ministri Ismaili.

Në anën tjetër, drejtori i ShSKUK-së, dr. Basri Sejdiu, ka theksuar se ndërtimi i këtij spitali do të jetë ndihmesë për banorët e Ferizajt me rrethinë, duke krijuar mundësi të jemi sa më afër pacientëve me kushte dhe infrastrukturë moderne. Ai u shpreh se prioritetet për zhvillimin e shërbimeve mjekësore në spitalet e përgjithshme do të mundësojnë që banorët të mos e kenë referencë QKUK-në, por shërbimet t'i marrin në spitalet e përgjithshme.

Kryetari i Komunës së Ferizajt, Agim Aliu, ka falënderuar ministrin Ismaili për mbështetjen



e madhe që ky projekt të realizohet në kohë. "Ferizaj, qytetarët e Ferizajt, do ta kenë një spital i cili do t'i trajtojë të gjitha nevojat e tyre", ka thënë

kryetari Aliu.

Ky projekt prej 10 milionë eurosh është ndërtuar në një hapësirë prej 2.7 hektarësh. Objekti shtatëkatësh, me 22

mijë metra katrorë, do t'i ketë 220 shtretër dhe të gjitha hapësirat dhe pajisjet që përmbushin standardet e një spitali të përgjithshëm.

Mbahet pjesa e parë e testit të maturës, afati i shtatorit



**EPOKA
ERE** **Qendresa RAMA**

SHTIME, 30 GUSHT - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, me rastin e mbajtjes së pjesës së parë të provimit të maturës (afati i shtatorit), ka vizituar të premtën Shkollën e Mesme Profesionale në Shtime, për ta parë rrjedhën e procesit të testimit të maturantëve në këtë

shkollë.

Ministri Bytyqi me këtë rast ka vlerësuar se tashmë është krijuar një traditë e mirë e organizimit të testeve dhe se është arritur që të ngrerhet vetëdija e nxënësve sa i përket përgjegjësisë në test. Bytyqi ka thënë se maturantët e kanë kuptuar se ata duhet të jenë të koncentruar në testimin e njohurive të tyre në lidhje me pyetjet të cilat janë përfshirë në test. "Ajo çka pamë brenda në

shkollë është një sukses për t'u admiruar. Pra, vazhdimisht kemi tentuar që në Testin e Maturës të krijojmë një vetëdije, në mënyrë që nxënësit të përqendrohen në dije dhe jo në metodat e kopjimit", është shprehur ministri Bytyqi. Pjesa e dytë e afatit të shtatorit do të mbahet më 7 shtator 2019, ndërsa në këtë fazë testimit i janë nënshtruar mbi 10 mijë maturantë.

27 punonjës të IPK-së u trajnuan nga agentë të FBI-së për luftim të korrupsionit

VUSHTRRI, 30 GUSHT (ER) - Në objektin e Akademisë së Kosovës për Siguri Publike (AKSP) në Vushtri ka përfunduar trajnimi i realizuar nga ICITAP-i amerikan, në të cilin kanë marrë pjesë 27 punonjës të IPK-së.

Ky trajnim është vazhdimësi e përkrahjes së IPK-së nga ICITAP-i amerikan për fuqizimin e

kapaciteteve profesionale në fushën e hetimeve.

Ligjërues të këtij trajnimi ishin ekspertë të lartë të FBI-së (Federal Bureau of Investigation - Byroja Federale e Hetimeve) nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në ceremoninë e diplomimit mori pjesë edhe kryeshefja e IPK-së, Miradije Kelmendi, e cila

në fjalën e saj të rastit ka falënderuar ekspertët dhe zyrtarët e ICITAP-it për kontributin e tyre në rritjen e profesionalizmit në IPK.

Pjesë e ceremonisë ishte edhe udhëheqësja e programit të ICITAP-it në Kosovë, Kimberly Rife, dhe drejtori i AKSP-së, Smajl Smakiqi.



Dogana shënon 20-vjetorin e themelimit, merr vlerësime pozitive

Drejtori i Përgjithshëm i Doganës së Kosovës, Bahri Berisha, ka thënë se ky institucion gjatë këtyre 20 vjetëve ka treguar rezultate në misionin e vet dhe vlerësohet si një nga institucionet me vlerat më të larta organizative. Ai ka theksuar se Dogana që nga themelimi ka qenë ndër kontribuuesit kryesor në mbledhjen e të hyrave



kanosen në kufij", ka deklaruar Haradinaj. Po ashtu, ai ka thënë se Dogana është partnere e gjithë afaristëve, sipërmarrësve, ekonomisë së vendit, sepse u mundëson atyre qarkullim të shpejtë të mallrave dhe të mirave të tyre. Sipas Haradinajt, ka sfida, por duhet të jemi më të saktë në punë, të jemi ambiciozë, të punohet më shumë dhe të bëhet kujdes i duhur që me të gjithë ata që punojmë, të na besojnë. "Është fat i madh që institucionet e sigurisë në Kosovë janë të besueshme, duke filluar nga ushtria, institucionet e rendit dhe ligjit, policia, inteligjenca, dogana dhe institucionet e tjera që kanë mision ruajtjen e rendit dhe ligjit në vend. Mund të bëjnë më shumë në të ardhmen dhe ju ftoj që të jemi bashkë në këtë drejtim", ka deklaruar kryeministri Haradinaj, duke theksuar se i gëzohet faktit që Dogana është anëtare e Organizatës Botërore të Doganave, punohet me standarde të avancuara dhe se premtimi i tij për 100 për qind Kosovë është i vërtetë dhe jo vetëm në këtë periudhë. Kurse ministri në detyrë i Financave, Bedri Hamza, ka thënë se ndihet kërenar me stafin e Doganës që vazhdon të bëjë punë të mirë në luftimin e kontrabandës, zbatimin e ligjit dhe ruajtjen e shëndetit të qytetarëve të vendit. "Dogana është institucioni i parë i

krijuar në Kosovë, është institucioni më i ndërtuar, i avancuar, i barabartë dhe i kalon vendet e regjionit dhe për këtë jemi kërenarë. Me punën tuaj na bëni kërenarë shpesh. Kosova sot, falë punës suaj, ka qëndrueshmëri. Shteti gjithmonë ka arritur t'i mbledhë të hyrat e planifikuara dhe ne kemi qenë më shumë ambiciozë në planet tona", u shpreh Hamza. Kurse drejtori i Përgjithshëm i Doganës së Kosovës, Bahri Berisha, ka thënë se ky institucion gjatë këtyre 20 vjetëve ka treguar rezul-

tate në misionin e vet dhe vlerësohet një nga institucionet me vlerat më të larta organizative. Ai ka theksuar se Dogana që nga themelimi ka qenë ndër kontribuuesit kryesor për mbledhjen e të hyrave "Dogana deri më sot ka arritur që për buxhetin e shtetit të mbledhë rreth 13 miliardë euro. Kjo është shumë e rëndësishme për forcimin e shtetit", u shpreh Berisha, duke shtuar se misioni i Doganës është edhe luftimi i krimeve transkufitare, kontrabandës dhe ekonomisë joformale.

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 30 GUSHT - Kryeministri në detyrë, Ramush Haradinaj, në ceremoninë e shënimit të 20-vjetorit të themelimit të Doganës së Kosovës, ka deklaruar se doganierët, përveç që bëjnë një punë të dobishme për shtetin për kontrollimin e mallrave, janë edhe pasqyra e shtetit në kufij. "Jam thellë i bindur se kushdo që hyn në Kosovë kur ju takon juve fiton respekt për vendin dhe popullin tonë përmes juve dhe ju falënderojmë për prezantimin e parë që i bëni Kosovës, për punën e mirë që bëni jo vetëm duke siguruar se Kosova ka të hyrat që i takojnë në bazë të ligjit përmes qarkullimit të mallrave, hyrjes së mallrave në Kosovë, por edhe duke mbrojtur Kosovën nga të gjitha rreziqet që i

Reçica nxjerr për konsultim publik konceptdokumentin për skemën e ndihmës sociale

PRISHTINË, 30 GUSHT (ER) - Ministri në detyrë i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, nëpërmjet një konference për medie ka lansuar të premtën për konsultim publik konceptdokumentin për reformë të skemës së ndihmës sociale, dokument i cili ka të bëjë drejtpërdrejt me mbrojtjen sociale të qytetarëve të Kosovës. Reçica ka thënë se analizat rreth legjislacionit për asistencë sociale tregojnë se ligji aktual nuk përkon më me rrethanat socio-ekonomike të vendit si dhe në disa raste është diskriminues për familjet përfituese, me kritere të cilat kanë krijuar vështirësi për mirëqenien sociale të këtyre familjeve, sepse këto familje, pasi janë larguar nga skema, kanë vazhduar të mbeten



të varfra ose pranë kufirit të varfërisë. "Me konceptdokumentin e ri ne synojmë të hartojmë një

ligj të ri të bazuar në standardet dhe praktikën më të mira evropiane dhe atyre të rajonit, me qëllim

kryesor eliminim e varfërisë në Kosovë", ka thënë ministri Reçica.

Ai ka thënë se në projektligj do të eliminohen kriteret diskriminuese, si ai i moshës së fëmijës pesë vjeç, do të eliminohen kategoritë e asistencës sociale (kategori I dhe II), do të bëhet ndryshimi i shkallës së ekuivalencës për llogaritjen e shumës mujore në bazë të madhësisë dhe strukturës demografike të ekonomive familjare, do të instalohen shtesat për fëmijët e familjeve nën asistencë për secilin fëmijë deri në moshën 18 vjeç, do të angazhohen përfituesit e asistencës sociale, të cilët janë të aftë për punë, duke i përfshirë në punë të rregullt, trajnime profesionale, masa aktive të tregut të punës, pa ndërprerje

nga asistencën edhe për një periudhë të caktuar kohore. "Në ligjin e ri të skemës së ndihmës sociale nuk do të ketë filtra përjashtues për familjet e varfra siç janë në ligjin aktual. Numri i personave që do të përfitojnë nga skema e ndihmës sociale do të rritet nga 106,416 në 167,766 persona apo nga 24,000 familje në mbi 27,000 familje për shkak të rritjes së proporcionit të familjeve më të mëdha si përfitues të SNS, me heqjen e filtrave në bazë të kategorive, ndërkaq numri i fëmijëve deri në moshën 18 vjeç të cilët përfitojnë shtesa do të jetë rreth 70,000 fëmijë", ka thënë Reçica.

Koncept-dokumentin për Skemën e Ndihmës Sociale do të jetë në konsultim publik 15 ditë në platformën elektronike të MPMS-së.

Nuk do të ketë taksë shtesë në Rrugën e Kombit

TIRANË, 30 GUSHT (ER) - Shoqëria koncesionare ka njoftuar të gjithë përdoruesit e Rrugës së Kombit (Autostrada Milot - Morinë) se nuk është e vërtetë dhe nuk ka asnjë pagesë apo taksë shtesë në sheshin e pagesave (Sheshi i Pagesës së Tarifës së Autostradës Milot - Morinë). Në njoftimin për media thuhet se të gjithë përdoruesit e këtij aksi

rrugor do të vazhdojnë t'i kryejnë pagesat sikurse deri më sot, pa asnjë ndryshim, sipas kategorisë së mjeteve të parashikuara në kontratën koncesionare. "Aktualisht, shoqëria koncesionare, në zbatim të kontratës së koncesionit dhe normave ligjore në fuqi, po realizon montimin dhe konfigurimin e peshoreve elektronike. Peshoret do të shër-

bejnë për monitorimin e automjeteve të rënda (nëse janë brenda normave të parashikuara në ligj ose jo). Qëllimi i këtyre pajisjeve është mbrojtja e elementeve rrugorë (shtresat e rrugës, veprat e artit, urat etj.) nga dëmtimet e mundshme që vijnë si pasojë e ngarkimit të mjeteve të rënda jashtë normave të lejuara", është thënë në njoftimin për media.



Bizneset kërkojnë nga qeveria e re angazhim më të madh për aftësimin e fuqisë punëtore



PRISHTINË, 30 GUSHT (ER) - Pavarësisht prej angazhimit të sektorit privat për aftësimin e të rinjve në industri të ndryshme, qeveria duhet të luajë rol kyç në përgatitjen e të rinjve në fusha të caktuara përmes programeve strategjike afatgjatë.

Kjo u tha në tryezën e organizuar nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë ku bizneset e pranishme dhanë rekomandimet e tyre rreth kapitalit njerëzor në Kosovë për qeverinë e re.

Drejtori ekzekutiv i Odës Amerikane, Arian Zeka, ka thënë se ndër sfidat më të mëdha me të cilat po ballafaqohen bizneset kosovare, e sidomos

ato në sektorin e prodhimit, shërbimeve dhe tregtisë, është edhe sigurimi i kuadrove të duhura të fuqisë punëtore, duke shtuar se qeveria e re duhet të fokusohet edhe në aftësimin e të rinjve për të qenë të gatshëm për tregun e punës. Përfaqësuesja e kompanisë Limak, Valentina Gara, ka theksuar se kapitali njerëzor është një faktor shumë i rëndësishëm për zhvillimin e individëve për përgatitjen e tyre profesionale. Ajo ka shtuar si të nevojshme investimin social në shoqëri për përgatitjen e të rinjve për tregun e punës përmes trajnimeve të ndryshme, duke thënë se zhvillimi ekonomik arrihet jo vetëm nga hapja e vendeve të

punës, por duke krijuar kuadrot e duhura në vendin e punës përmes investimeve të bëra nga qeveria në programe të ndryshme.

Kryeshefi ekzekutiv i kompanisë Orbico, Fikret Havolli, ka thënë se mungesa e kuadrove të kualifikuara duhet të adresohet si problem kryesor për të arritur zhvillim ekonomik të qëndrueshëm. Havolli ka pohuar se qeveria e re në fokus duhet ta ketë krijimin e një strategjie afatgjatë për ta aftësuar fuqinë punëtore si dhe ta prioritetizojë zhvillimin e fushës së ndërmarrësisë. Më tutje, ai ka shtuar si rekomandim krijimin e një pakoje stimuluese për të rinjtë

në aftësimin e tyre sipas elementeve të KPI e cila do të ndihmonte në mbështetjen dhe motivimin e talentëve në vend për t'u zhvilluar edhe më shumë.

Ndërsa përfaqësuesi Rainer Gerke nga kompania gjermane "Getting Competent" ka theksuar rëndësinë e promovimit të faktorëve të cilët mbajnë fuqinë punëtore në vend në mënyrë që Kosova të mos ketë mungesë në industri të caktuara. Ai shtoi se qeveria duhet t'i identifikojë arsyet se pse të rinjtë largohen nga vendi dhe të fokusohet për krijimin e kushteve të favorshme për aftësimin e tyre për ta zhvilluar karrierën e tyre në vend, duke shtuar se kapitali

njerëzor duhet të jetë faktor i cili nxit të rinjtë të mos largohen në tregje ndërkombëtare.

Ndërsa Ariel Shaban nga kompania prodhuese KIVO ka thënë se nevojiten reforma në programet afatgjatë të punës praktike në universitete, duke përmendur si kyçe bërjen e një studimi konkret të nevojave në këtë drejtim. Ai ka shtuar se vendimet e marra nga qeveria do të bazoheshin në këto studime profesionale. Po ashtu, ai ka shtuar si të rëndësishëm parësore parashikimin e pozicioneve afatmesme dhe afatgjatë duke thënë se nevojitet qasje më sistematike në edukimin profesional për të balancuar ofertën dhe kërkesën në treg.

MTI-ja: Nuk kemi marrëveshje me BIK-un dhe Komunën e Prishtinës për shërbimet e funeraleve

PRISHTINË, 30 GUSHT (ER) - Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI) ka dhënë sqarim lidhur me raportimet në media, të datës 30. 08. 2019, për marrëveshjen ndërmjet Komunës së Prishtinës, Bashkësisë Islame të Kosovës (BIK) dhe MTI-së për

shërbimet funerale. Përmes këtij sqarimi, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë e informon publikun se nuk ka asnjë marrëveshje të tillë mes BIK-it, Komunës së Prishtinës dhe MTI lidhur me shërbimet e funeraleve, siç është raportuar sot në media elektronike.

"Shërbimet e tilla nuk rregullohen në fushëveprimtarinë e MTI-së dhe as nuk janë kompetencë e saj. Andaj ky mund të jetë ndonjë gabim teknik nga ana e mediave raportuese sa i përket përfshirjes së MTI-së", është theksuar në sqarimin e MTI-së.



NGRITJE TË TEMPERATURAVE, DERI NË NGRIRJE TË THELLË PARA ZGJEDHJEVE PARLAMENTARE!



**Behxhet Sh.
SHALA - BAJGORA**

Aderimet apo legalizimi i prostitucionit politik: Nuk kanë të ndalur aderimet e personaliteteve me peshë dhe rëndësi të madhe jo vetëm për skenën politike në Kosovë, por që paraqesin vlerë të pazëvendësueshme edhe për politikën ndërkombëtare dhe pa të cilët gjeopolitika botërore do të falimentonte. Për çdo ditë keni fotografi të liderëve partiakë, me prurjet e vjetra apo me konservat politike, të ndryshkura para shumë viteve, por se konsiderohen si infuzion për fitore thuaja të të gjitha partive apo koalicioneve që do të marrin pjesë në zgjedhjet e 6 tetorit 2019. Askush dhe asnjëri pas këtyre zgjedhjeve nuk dëshiron të jetë i dyti sepse të gjithë duan të jenë të parët. Dhe, të gjitha sondazhet i nxjerrin si fitues, kurse të tjerët i lënë në fund të pusit. Gjatë aderimeve të fundit u inkuadruan në politikë këngëtarë, artistë dhe artiste, sportistë dhe sportiste, trajnerë dhe disenjatorë, përpunues të leshit dhe përfitues të përseshit, asi që shesin moral në shtëpi publike dhe në forume politike, ata që kanë studiuar në Norvegji dhe ata që janë shkërdhyer në Serbi, ata që kanë kryer kurse patriotike në Kumrovc të Kroacisë dhe ata që familjarisht kanë lehur sipas notave dhe muzikës së Jugosllavisë dhe Serbisë, ata që kanë kryer kursin e moralit të lartë tek Atë Ivani, te pop Jovani apo te stërshitësi i mishit të prishur për Kurban, Mulla Lesh Hasani. Biografia tipike, klasike dhe patriotike e një të aderuarit në cilindo subjekt politik: Kam përfunduar shkollimin fillor në Muqibabë të Kamenicës, më ka bërë synet Hasan Leshi në shtëpinë e uzurpuar të Nikoliq Jovicës, për shkollim të mesëm i kam dhënë dy lopë dhe 10 pula sipas kurrikulave të Afrikës, kam studiuar botanikën duke mbjellë kanabis dhe hashash

sipas Koza Nostras italiane dhe skinhedsave të Amerikës, masterin për financa e bëra në ishujt Kajmanë duke pastruar para të politikanëve kosovarë dhe vëllezërve shqiptarë, doktoraturën e bëra sipas rregullave globale duke kurdisur arka fiskale dhe tash ligjëroj në Kolegjin për Etikë dhe Moral në Mishlesh, kurse jam profesor me korrespondencë edhe në Bangladesh. Kam një të kaluar të pastruar kriminale sepse filan prokurorit i kam ndërtuar shtëpinë, kurse gjykatësit kryesor i kam futur në bythë alltinë. Nuk kam probleme me ligjet, së paku me Kushtetutën, sepse jam i pastër si kanalizimi në Emshir dhe jo pse më kanë tuten. E tash, lexues të nderuar, si mos ta pranoi në parti intelektualin e Bangladeshit me diplomë dhe allti, si mos të votoni për këto prurje të reja politike hajdutë me trashëgimi gjenetike! Thënë të drejtën, isha shumë i interesuar që edhe unë të bëj fotografi dhe të hyj në histori duke u bërë pjesë i cilitdo subjekt politik që do të dalë i pari në këto zgjedhje. I bëra lëvizjet e domosdoshme dhe të shpejta: e thirra Isën, por nuk u lajmërua, ose e ka ndërruar numrin e telefonit ose e ka njohur numrin tim të telefonit. Si dhëndër i Ismetit të Kodrës së Trimave, shpresat i vara tek ai, por doli se shkova pas koçë.. të dashit. Liburnit i buzëqesha fort dhe me një sensualitet të papërsëritshëm, sikur Vjosa Isës pasi e nominoi për kryeministër, nuk pata feed back që prisja. Fort e përqafova Ramushin kur e takova, por më katapultoi me ata muskujt si të Shvrçenegerit kur ishte zgjedhur mister Universum. U përpoqa pak më butë duke e korrupuar Besnikun në "Rings" me një kafe 0.80 centë, plus 0.20 centë haraç për Buqin por, nuk erdhi. Kam dëgjuar se Behgjet Pacolli të vetmin kusht që i ka vënë Fatmirrit për koalicion ka qenë, jo ndonjë post, por të mos më pranojnë si anëtar të Nismës Socialdemokrate, pra Behgjet Pacolli in, Behxhet Shala out. Populli thotë se: "Ku e ke uzdajën e ke murtajën...". Ia luajta bishtin Ilmisë dhe Kadrisë, kurse ata ia ndanë postet dhe librezën, Gjylfidares dhe Abdylkadër Sadrisë! Më duhet të theksoj dhe pranoj se nuk di të këndo, nuk di të

vallëzoi, nuk di të kompozoi, as të dirigjoi, me 100 intervenime kam mbaruar shkollën e mesme të mjekësisë, kurrë nuk kam pasur rastin të bëhem pjesë e historisë, nuk di çka janë artet marciale, kurse jam haberus për politikën strategjike globale. Në moshën 12-vjeçare kam mësuar shkrim-lexim, kurse në moshën 15-vjeçare e kam marrë një dysh në vizatim për një shkarravitje fantastike sepse, në vend të kalit, e kam vizatuar gomarin e, në vend të pelës, e kam vizatuar zagarin. Të vetmen punë që di nga pak ta bëj është të luaj koç... prandaj shpresova se, së paku në Partinë Euroatlantike të Mongolisë, mund ta gjej një vend për t'u sistemuar. Si fëmijë, kur ruaja bagëtinë dhe bujqësinë gjatë pushimeve verore te dajat në Lupç të Epërm, luaja pidpida, gugja apo klička sikur edhe u bëra njëfarë eksperti për degërxhik. Thashë se përvoja ime e pasur në të kaluarën do të më ndihmojë të bëhem pjesë e ndonjë partie, koalicioni apo ekuacioni, por po del se politikanët tanë këto lojëra i kanë perfeksionuar, sidomos lojën me gugja, për faktin se, qe 20 vjet luajnë gugja me ne dhe asnjëherë nuk kanë humbur. Pra, edhe kësaj radhe më dështoi aderimi, prandaj po mbetem, as deputet e as pushtet!

Koalicionet si ngjizje e kurvërisë politike dhe morale: AAK-ja e Ramush Haradinajt, si parti ekstremisht e djathtë, e bëri një koalicion krejtësisht normal me PSD-në, parti e deklaruar si e majtë. Kombinim krejtësisht i natyrshëm për forcim të shtetit e sidomos për marrje të pushtetit. AAK-ja qëndron mirë, ka rritje më shumë se të gjitha partitë, por se nuk i fiton zgjedhjet me partnerin. Këtij formacioni jofitues, por kualifikues, i mungon një parti e qendrës. Në Kosovë parti që krejt kohën ka qenë në qendër, më shumë për të keq, klientelizëm, thithës të tenderëve dhe jo vetëm të tenderëve, shantazhim të partive të tjera sipas parimit një deputet pesë ministri, është AKR-ja - Aleanca Kosovare e Rrenave. Realisht, po të mos ishte Hashimi - Shimi, Gjet Colli do të hynte në orgji

politike - pushtetore midis Ramushit dhe Korbit. Shkoi te Fat Falti duke e drejtuar bigën dyremëshe - auspuhin dybothësh në drejtim të Hasreti Isës dhe Kadrisë. Procedura pastaj vazhdon në përputhje me nevojat e shtetit, bashkësisë ndërkombëtare, popullit të Turkmenistanit dhe vejjshave të Azerbejxhanit e që të gjithë këta janë nën urdhrat e komandant Shimit si komandant suprem i forcave të armatosura që ia garanton edhe Kushtetuta. Edhe Partia e Drejtësisë u bë pjesë e këtij koalicioni, jo për të fituar, por për të mbijetuar!

Nisma Socialdemokrate e Malishevës dhe Aleanca Kosovare e Rrenave e Karaçevës: Edhe këtu kemi bashkëdyzim apo bashkëshkërdhyerje të dy subjekteve politike krejtësisht të kundërta: Nisma Socialdemokrate që është e deklaruar si e majtë apo parti për padrejtësi sociale dhe AKR-së si një parti tipike e djathtë apo më mirë të them parti që ka dalë nga koç... e djathtë e Hashimit. Dhe se ende mrizon nën atë hije. Kësaj partie iu bashkëngjiti edhe një amebë që përshtatet në çdo vend, në çdo temperaturë dhe në çdo kanalizim. Ky koalicion është bërë për barazim të llogarive pas zgjedhjeve. Shumë më shumë do të fitojë Begja se Fat Falti, si gjithëherë. Nisma është e metastazuar nga patriotë me emër dhe me fletë, prandaj këtij gjerdani i është bashkëngjitur edhe kryepatrioti Behgjet Pacolli për ta përmbushur konstatimin e Azem Bejtës apo për ta rrëzuar tezen e Azem Bejtës se: "Më m.t nuk bëhet ..." Bëhet, bëhet, ja koalicioni. Në këtë përzierje leshrash Jakup Krasniqi është zënë më së ngushti; nuk e ka duruar Pacollin edhe kur ky ishte në Kremlin, tash ia kanë futur në gji... Jakupi apo Baca Kupë që e quajnë ata që duan ta mashtrajnë, me letra ka shumë pushtet në këtë parti, është kryetar i Këshillit Kombëtar të Nismës, sikur dikur Haxhi Lleshi në Shqipëri. Po më duket se nuk po ia pyesin fare letrat Jakupit, ia kanë ndërruar arkivin e historisë duke e renditur Behgjet Pacollin edhe mbi Hasan Prishtinën apo krahe të djathtë të Skënderbeut andaj,

Jakupi si historian me 500 libra të shkruara, e ka përqaftuar Bacën e Marecit si bashkëpjesëmarrës dhe bashkëvuajtës në zgjedhjet e 6 tetorit 2019. Unë nuk kam shkollë të përfunduar, jam njëfarë autodidakti spekulativ por, po të isha në vend të Jakupit, në çastin kur Gjeti bënte sfilatë të koalicionit me Fatin, menjëherë do të isha dorëhequr dhe kisha shkuar në Negroc për të kontrolluar nëse dhelpira ia ka ngrënë pulat apo zogjtë.

Partia Demokratike e Kosovës: Është në pozitën e vejjshave të Gostivarit; askush nuk martohet me to e sa për ndonjë seancë janë të mirëseardhura dhe të domosdoshme. Partitë kosovare - shqiptare ia kanë bërë bllok PDK-së sikur që partitë apo koalicioni i partive serbe në Kosovë ia ka bërë bllok Listës Serbe. Mirëpo, në aspektin material dhe seksual më mirë është të mos martoheni, por të bashkëjetoni. Këtë parim po e ndjek edhe PDK-ja. Falë racizmit të partive të tjera në Kosovë dhe injorancës së skajshme politike dhe praktike ndaj PDK-së, këta u bënë votues apo përkrahës të mëdhenj të PDK-së pasi mobilizuan elektoratin e PDK-së e që këtë nuk do ta bënte më mirë as vetë Kadri Veseli. Nëse shkohet në zgjedhje pa koalicione të mëdha, ma merr mendja se PDK-ja del fituese jo se e meriton, por se partitë konkurrenente janë më leshko se PDK-ja. Shumë do të varet se çfarë liste do ta bëjë PDK-ja jo për t'i fituar zgjedhjet, por për të fituar më shumë mandate deputetësh. Nëse PDK-ja i fut në lista do këshilltarë si kategori sociale intelektuale dhe mercenarë, pisk do t'i ketë punët. Sot PDK-ja i ka dy probleme të mëdha: Hashimin dhe granimin. Granimin PDK-ja e ka kryesisht për dasma, syneti, kanaxheqe dhe ahengje patriotike ku nuk duhet të keni fare ose shumë pak përgatitje politike. Po të mos ishin këto partitë kosovare - shqiptare, PDK-ja do të mrizonte nën dud të opozitës, jo vetëm një mandat, por pak më gjatë. Kadri Veseli bëri mirë që nuk e arnoi qeverinë, Kadri Veseli do të bënte edhe më mirë që të harronte se ku Behgjet Pacolli e ka shtëpinë! Nëse PDK-ja në lista nuk do të ketë të

korruptuar, nuk do të ketë bijë dhe bija të të fortëve kah koç... dhe të lodhtë nga mendja, fitoren do ta ketë të garantuar. Pa koalicion të mëdha. Partitë kosovare -shqiptare në Kosovë po gabojnë duke e nënçmuar strukturën e ndërtuar të PDK-së thuaja 20 vjeçe dhe shtresën e votuesve klientelistë. Struktura e PDK-së dhe LDK-së punojnë sipas modelit të oktapodit, ia hiqni një kokë, i dalin dhjetë të tjera. Për PDK-në do të ishte më mirë që të dilte në opozitë sepse do të lirohej nga përgjegjësia për vendimmarrje që do të jenë të rënda dhe të dëmshme. Përfundimisht, PDK-ja vullnetarisht nuk do të kalojë në opozitë.

Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Lëvizja Vetëvendosje: Gjatë dy zgjedhjeve të fundit po kalojnë nga gjendja e dashurisë platonike deri në përleshje fizike. Nuk kanë fat në dashuri e as qëndrueshmëri në besnikëri. Asgjë nuk i bashkon përveç luftës për pushtet dhe urrejtjes ndaj PDK-së që më shumë i dëmton sesa që i ndihmon. Dështuan me VLAN-in, thyen

dhëmbët me PAN-in. Tash, e treta e vërteta: duan të bëjnë koalicion parazgjedhor për ta liruuar Kosovën nga "serbët" e Drenicës, me ndihmën e "shqiptarëve" të Graçanicës! As këta në aspektin ideologjik dhe politik nuk dallojnë nga koalicionet më lart: LDK-ja e deklaruar si parti e djathtë që mendon dhe pshurrë si Sali Berisha dhe Lul Basha dhe Lëvizja Vetëvendosje krejtësisht e pozicionuar ndryshe, si parti e majtë, si Berti Sanders dhe Roza kokëtrasha. Është një dashuri sadiste - mazokiste ku nuk punon kimia, ka mungesë pasioni dhe ligështim ereksioni. Prandaj marrëdhënien kurrë nuk po mund ta çojnë deri në fund. Prandaj edhe po mungon ngjizja parazgjedhore sikur që do të bëhet edhe më e vështirë ajo pas zgjedhjeve. Në pamje shumë të fortë dhe të fuqishëm brenda janë si eunukët apo ruajtësit e haremit të sulltanëve. Shih me sy, nuk janë për ty. Koalicionin parazgjedhor po e arsyetojnë me një çmim të lartë që deri më tani vetëm UÇK-ja dhe NATO-ja e kanë realizuar, çlirim të Kosovës dhe çkapje të shtetit. Kosova është

çliruar, kurse kapja ka qenë kontribut i të gjithëve, në rastin konkret kapjen e kanë bërë kapjen bashkë të Kosovës, njëri e ka mbajtur, tjetri e ka kapur. Pastaj, janë ndërruar. LV-ja ka pasur vetëm kapje lokale; Prishtinën që tani nuk po mund ta çkapin nga Shpendi. Mytaheri në Prizren nuk po di as të kapë si duhet. Vetëm LV-ja deri më tani ka të drejtë morale të flasë për çkapje të shtetit sepse të tjerët, të gjithë janë kapës, kush më shumë e kush më pak. Nëse LDK-ja është e sigurt se i fiton zgjedhjet e 6 tetorit, pse i duhet koalicioni parazgjedhor?! Nëse LV-ja është e sigurt se i fiton zgjedhjet, pse po këmbëngul në koalicion parazgjedhor?! Le t'i fitojnë zgjedhjet atëherë le të merren vesh duke e ndarë tortën apo helmin! Pse hidhërohet LV-ja që LDK-ja e ka nominuar Vjosën për kryeministre kur vetë e ka nominuar Albinin për kryeministër! Mua më pengon fakti se Vjosa më shumë po ka përkrahje si femër se në bazë të aftësive që i ka! Po riciklohet Zariqja, tash kryeministre. Unë e pranoj çdo kryeministër që i

fiton votat mirëpo, nëse bëhet një krahasim midis Albin Kurtit kandidat dhe Vjosa Osmanit atëherë, përkundër dallimeve që mund t'i keni me Albinin, duhet të pajtohemi me faktin se këtu nuk ka vend për krahasime: Albini është para Vjosës, por edhe të tjerëve shumë larg, pakrahasueshëm larg! Këtij koalicioni fort i ka fryrë edhe një pjesë e ashtuquajturës shoqëri civile jo se e duan çkapjen sepse edhe vetë janë kapës, por se duan të bëhen pjesë e kapjes me mandat dhe institucionalisht!

Lëvizja për Bashkim: Lëvizja për Bashkim ka deklaruar se do të bëjë koalicion vetëm me ato parti apo individë që janë për ndryshim të kufijve dhe të territoreve. Po del të jetë shumë e fuqishme sepse ka apo mund të ketë përkrahës shumë të fuqishëm si: Hashim Thaçi, Gjet Pacolli, Goran Rakiqi, Aleksandar Vuçiqi, Ivica Daçiqi, Putini, Edi Ramë Kokëdhima, Gjon Bolton dhe Donald Tramp si dhe ish-rrugaçet e Brukselit, Federika Mogerini dhe mashtguesi vjenez Johaness Sebastain Han.

Toni dhe Vjosa, shoferë apo shoqërues të Ha-Shimit: Vjosa Osmani, kandidate për kryeministre, e zonja shumë në fushën e Kushtetutës dhe gjykatave ndërkombëtare, ndonëse ende ndodhet në furrig, ka deklaruar se do ta dërgojë Hashimin në shtëpi. Ashtu ka deklaruar edhe Antoan Quni Grizmani se do ta dërgojë Hashimin në shtëpi, përkatësisht Thaçin. Fillimisht mendova se e kanë parë të lodhur Rasim Thaçin - Cimën dhe kanë vendosur ta dërgojnë në shtëpi, por po del se ata duan ta dërgojnë Hashim Thaçin - Shimën në shtëpi. Njëri shofer, tjetri si shoqërues sigurimi, përkatësisht shofere Vjosa, kurse shoqërues Anton trimi. Duket se këta e njohin Kushtetutën e Kosovës aq sa vullkanin Etna në Çabrat të Gjakovës! Po edhe nëse 120 deputetë do të votojnë në mëngjes për shkarkim të Hashimit, pas drekës me fruta di mare (bagëti dhe bujqësi deti), kushtetutka e Ahtisarit vetëm sa do t'i forcojë fotelen e Hashim Carit! Nuk ka asnjë ndryshim prej këtyre zgjedhjeve, rahmet shpirti iu pastë!



'Katalogu i problemeve të Vitisë', çështja e ujësjellësit problem primar

Viti, 30 GUSHT (ER) - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka prezantuar katalogun e çështjeve për Komunën e Vitisë, që përfshin problemet me të cilat përballen qytetarët dhe bën priorizimin e disa çështjeve esenciale që duhet të përfshihen në plani-

fikimet buxhetore të komunave për vitin 2020. Si rrjedhojë e një hulumtimi në terren, në këtë komunë janë identifikuar probleme në infrastrukturën rrugore, rrjetin e kanalizimit, furnizimin me ujë të pijes, transport publik, gjendjen e

shkollave, menaxhimin e mbeturinave dhe shërbimet shëndetësore. "Çështja e ujësjellësit paraqet problemin më të madh në Komunën e Vitisë. Shumica dërrmuese e fshatrave në të cilët është bërë hulumtimi kanë probleme me ujë të pijshëm, të cilat

çështjen e ujit e konsiderojnë si kërkesë kryesore. Problem i madh është edhe uji i kontaminuar në fshatra e shkolla të kësaj komune. Nga mungesa e sistemit të ujësjellësit, fshatrat furnizohen nga pusët e në të shumtën e rasteve uji është i papijshëm", është thënë në

komunikatën e KDI-së. Në shumicën e fshatrave të Komunës së Vitisë ka deponi ilegale të materialit ndërtimor dhe të materialeve të tjera, ndërsa në disa fshatra mbledhja e mbeturinave nga kompanitë përgjegjëse nuk bëhet fare.

ShBA-ja krijon Komandën e Hapësirës

UASHINGTON, 30 GUSHT - Me një ceremoni në Shtëpinë e Bardhë është zyrtarizuar krijimi i Komandës Hapësinore të Shteteve të Bashkuara. Komanda e re do të ndihmojë Ushtrinë amerikane t'i mbrojë interesat e ShBA-së në hapësirë. Pas kësaj, administrata e presidentit Trump shpreson të krijojë edhe forcat hapësinore.

Shteteve të Bashkuara iu shtua edhe një komandë ushtarake, ajo e hapësirës.

"Kjo është ditë e shënuar, në të cilën vlerësohet rëndësia e hapësirës në sigurinë dhe mbrojtjen kombëtare të Amerikës",

tha gjatë ceremonisë presidenti Donald Trump.

Komanda e Hapësirës radhitet si komanda e 11-të luftuese. Secila ka mision ose gjeografik ose funksional.

Komanda e re do të riorganizojë dhe përmirësojë mbrojtjen dhe teknologjinë hapësinore, në një kohë kur raportet me Rusinë dhe Kinën janë ashpërsuar.

"Kundërshtarët tanë po e armatosin orbitën e Tokës me teknologji të reja, që kanë për objektiv satelitët amerikanë që luajnë rol kryesor në operacione ushtarake dhe mënyrën e jetesës në vend", tha presidenti Trump.

Rëndësia e hapësirës është shumë e madhe për veprime të përditshme, si navigimi ose veprimet bankare.

Asetet hapësinore kanë rol të madh edhe në misione ushtarake, nga lëshimi i raketave e deri te grumbullimi i informacioneve sekrete.

Zyrtarë të administratës thonë se komanda e re është një hap para në synimet e mëdha të presidentit.

"Si komandë luftarake e unifikuar, Komanda e hapësirës është hapi tjetër i madh drejt krijimit të Forcave të Pavarura Hapësinore si një shërbim shtesë



ushtarak", tha Sekretari amerikan i Mbrojtjes, Mark Esper.

Forca Hapësinore do të ishte dega e parë ushtarake që kur

Forca Ajrore u krijua pak pas Luftës së Dytë Botërore.

Por, për krijimin e saj duhet miratimi dhe financimi i Kongresit, gjë që ende nuk ka ndodhur.

Varshava dhe Uashingtoni pajtohen për pozicionimet e trupave të reja amerikane

Ministri polak i Mbrojtjes, Mariusz Blaszczak, ka thënë se Varshava dhe Uashingtoni janë pajtuar për gjashtë lokacione të reja për pozicionim të trupave amerikane në Poloni, një ditë pasi presidenti i Shteteve të Bashkuara, ka anuluar një vizitë në lindje të Evropës



VARSHAVË, 30 GUSHT - Varshava dhe Uashingtoni janë pajtuar për gjashtë lokacione të reja për pozicionim të trupave amerikane në Poloni, ka thënë ministri polak i Mbrojtjes, Mariusz Blaszczak, një ditë pasi presidenti i Shteteve të Bashkuara, ka anuluar një vizitë në lindje të Evropës.

Trumpi ka anuluar udhëtimin e tij në fundjavë për shkak të një stuhie që po arrin në Florida, andaj nën-presidenti i SHBA-së, Mike Pence, pritet të marrë pjesë në ngjarjet e plan-

ifikuar në Poloni, për të shënuar 80-vjetorin e nisjes së Luftës së Dytë Botërore, transmeton agjencia e lajmeve, Reuters.

"Ne jemi pajtuar për gjashtë lokacione dhe kemi diskutuar për të shtatin", ka thënë Blaszczak në një konferencë për media, bashkë me këshilltarin amerikan për Siguri

Kombëtare, John Bolton, i cili ka shkuar në Poloni për këtë përvjetor.

Në muajin qershor, Polonia ka nënshkruar një marrëveshje për rritje të prezencës ushtarake amerikane në tokën e saj, për të luftuar kërcënimin në rritje nga Rusia, prej kur kjo e fundit ka aneksuar Krimenë nga Ukraina më 2014.

Polonia kufizohet në verilindje me enklavën ruse, Kaliningrad, ku gjenden disa prej raketave më të avancuara në Moskës.

Marrëveshja ushtarake e nënshkruar në muajin qershor, do të rrisë numrin e trupave të përkohshme amerikane në Poloni për 1,000 më shumë.

Aktualisht në këtë shtet janë rreth 4,500 trupa amerikane në

kuadër të forcave të NATO-s.

"Polonia ka qenë një partner i jashtëzakonshëm i SHBA-së dhe NATO-s, duke shpenzuar më shumë se 2 për qind të bruto prodhimit të brendshëm në mbrojtje", ka thënë Bolton në konferencë.

Ai ka thënë se vizita e Trumpit do të riplanifikohet sa më shpejt që është e mundur.

Negociatat për qeverinë e re italiane nuk kanë përfunduar ende

ROMË, 30 GUSHT - Partia italiane, Pesë Yjet ka paralajmëruar të premtën se tentimet për të krijuar koalicionin me Partinë Demokratike të qendrës së majtë, ende ka mundësi të dështojnë.

Drejtuasi i kësaj partie, Luigi Di Maio, ka thënë se "ne ose do të arrijmë marrëveshje që bazohet në pikat e programit tonë, ose do të ndalem këtu".

Nëse Partia Demokratike, e cila ka qenë armike e Lëvizjes Pesë Yjet vetëm disa javë parë, nuk pajtohet me kërkesat kyçe të Lëvizjes atëherë "do të jetë më mirë që të kthehemi te kutitë e votimit sa më shpejt që është e

mundur", ka thënë Di Maio. Paralajmërimet e tij kanë ardhur pas disa konsultimeve me kryeministrin teknik, Giuseppe Conte, të cilit i është kërkuar që të formojë qeverinë e re, pas shpërbërjes së koalicionit populist të Italisë më herët gjatë këtij muaji.

"Ne nuk jemi duke shikuar për një qeveri sa për të thënë, ne konsiderojmë se disa prej pikave tona të programit janë të domosdoshme", ka thënë ai. Reagimet e Partisë Demokratike kanë qenë të shpejta, pasi Graziano Delrio, ka insistuar se partia "është e përkushtuar që me besnikëri të mbështesë përpjekjet e kryeministrin Conte. Këto

përpjekje kanë kthyer besimin në Itali".

"Ultimatimet e Di Maios ndaj kryeministrin teknik janë plotësisht të papranueshme", ka thënë ai.

Lideri i Partisë italiane, Liga, Matteo Salvini, pati bërë thirrje për zgjedhje të parakohshme para prishjes së koalicionit që ka ekzistuar në mes të partisë së tij dhe Lëvizjes Pesë Yjet, duke thënë se dallimet brenda partnerëve të koalicionit, nuk mund të tejkalohen.

Bazuar në sondazhe, partia e Salviniit gëzon dukshëm më shumë përkrahje, kryesisht për shkak të qasjes së tij kundër



migrimit ilegal. Në zgjedhjet e vitit të kaluar, Lëvizja Pesë Yjet ka fituar dy herë

më shumë vota sesa Partia Liga, mirëpo sondazhet parashikojnë se gjendja tani është ndryshe.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



AUTOSHKOLLA "RITMO - L"

**Auto Shkolla
"RITMO - L"
Prishtinë**

**Eksperienca jonë
- përfitimi i juaj.**

Ju mirëpret:

Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "

Tel / kontakt:

044 248 173

044 200 604

044 375 333

E rrallë

Tre muaj burg derisa u vërtetua që ishte mjaltë shtëpie, jo drogë

Një emigrant po kthehej nga një udhëtim për pushime në vendlindje, por nuk e dinte që kjo do t'i kushtonte lirinë. Leon Hoton, banues në Merilend të ShBA-ve, emigrant me "Green-Card, kishte shkuar për pushime në vendlindje, Xhamajka. Që



atje u kthye me tri shishe mjaltë. 46-vjeçari, baba i gjashtë fëmijëve, qëndroi për 82 ditë i burgosur nga autoritetet derisa u vërtetua që shisheet kishin vërtet mjaltë shtëpie dhe jo drogë, të cilat ai i kishte blerë nga një shitës buzë rruge.

FOTO E DITES



Zogjtë janë fotografuar derisa dielli lindte mes tymit nga një trakt i djegur i xhunglës së Amazonës në Brazil /Reuters/

E jashtëzakonshme

Kirurgun "hero" e zëgjumi në dysheme, bëri shtatë operacione pa pushim

Një kirurg nga Kina zgjodhi të mos bënte asnjë minutë pushim që pacientët të merrnin trajtimin në kohë. Dai Yu bëri plot shtatë



operacione dhe më pas e zuri gjumi në korridorin e spitalit. Ai filloi punën në 8:00 të mëngjesit dhe e përfundoi në 17:00 të pas-

dites. Ishte aq i lodhur, sa u ul në dysheme të flinte për 10 minuta sa kolegët të përgatishnin sallën për operacionin tjetër.

BARSOLETA E DITËS



Djali: Babë a na godet neve kjo kriza financiare?
Baba: Jo, i godet ata që kanë para?
Djali: Po neve?
Baba: Neve na sos na qetë përtokë!



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Çdo ditë në ora 15:30 The Angry Birds Movie 2 (3D)

Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 39 min
 Rolet: Jason Sudeikis, Josh Gad, Leslie Jones, Bill Hader, Rachel Bloom, Danny McBride, Peter Dinklage, Nicki Minaj, etj.

Regjia: Thurop Van Orman



Në ora 17:30

GOOD BOYS

Aventurë/Komedi; 1 orë 29 min

Rolet: Jacob Tremblay, Keith L. Williams, Brady Noon, Molly Gordon, Lil Rel Howery, Will Forte, etj.

Regjia: Gene Stupnitsky




Çdo ditë në ora 19:15

"HOBBS & SHAW"

Aksion/Aventurë/Triller; 2 orë 15 min

Rolet: Dwayne Johnson, Jason Statham, Idris Elba, Vanessa Kirby, Helen Mirren, etj.

Regjia: David Leitch




Çdo natë në ora 21:30 ONCE UPON A TIME IN HOLLYWOOD

Komedi/Dramë; 2 orë 41 min

Rolet: Leonardo DiCaprio, Brad Pitt, Margot Robbie, Al Pacino, etj.

Regjia: Quentin Tarantino



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.



DASHI

Keni shumë çështje për të


zgjodhur gjatë ditës së sotme. Pjesa e parë e ditës do të ketë aktivitete të shumta. Më e qetë mbrëmja.



DEMI

Idetë që keni duhet t'i vini në

veprim dhe t'i zhvilloni. Problemi i vetëm është se s'po gjeni pak kohë të lirë për ta bërë këtë gjë.



BINJAKËT

Dikush po mudohet t'ju

vërë shkopinj nën rrota. Nëse keni autokontroll të mjaftueshëm do të dini si të dilni nga kjo situatë.



GAFORRJA

Mund t'i lini gjërat të rrjedhin

vetë. E rëndësishme është që në një moment të caktuar ju do të keni kohën tuaj për të realizuar atë që doni.



LUANI

Hap pas hapi do të arrini të

mblidhni dhe ju sukseset tuaja. Shijoni çdo gjë që ju ofron jeta sepse e meritoni.



VI RGJERESHA

Në varësi të humorit do të keni

edhe sjelljen sot. Por personat që ju rrinë pranë nuk e meritojnë arrogancën tuaj.



PESHORJA

Jeni vëzhgues të mençur dhe

sigurisht kjo gjë ju favorizon në shumë situata. Sot mendoni vetëm se si të relaksoheni.



AKREPI

Sot nuk duhet të ekzagjeroni në

kërkesa. Jo të gjitha gjërat që kërkonit mund të kenë kushtet për t'u realizuar.



SHIGJETARI

Mos kërkonit aventura sot sepse

nuk do të mund të përballoni dot rrezikun. Një sekret i kohëve më parë do t'ju shqetësojë.



BRICJAPI

Indiferenca në shumë raste

është arma më e mirë për të mos vuajtur. Jeta na rezervon momente të dhimbshme që mund të na lëndojnë.



UJORI

Konsideroni atë që ju thotë instikti juaj

i pagabueshëm sot. Mund të jetë momenti për një ndryshim të madh dhe total në jetën tuaj.



PESHQIT

Sot do të keni mundësinë të

analizoni mirë ngjarjet që po ndodhin rreth jush. Paraqitet një ditë e qetë dhe pa shumë aktivitete.


Joe Jonas vendos imazhin e gruas në xhaketën e tij



Këngëtarja Joe Jonas është i dashuruar marrëzisht pas gruas së tij, Sophie Turner. Këtë herë ai e dëshmoi dashurinë me anë të një xhaketë që pati veshur. Joe mbrapa xhaketës pati të

vendosur imazhin e rolit të gruas së tij në serialin Game of Thrones. Sansa Stark është personazhi Sophie Turner në këtë seri. Jonas Brothers mbrëmë kanë performuar në Madison Square Garden në Nju Jork.

Albumi i Taylor Swift më i shituri në Kinë



Këngëtarja e njohur, Taylor Swift, ka korrur suksese të mëdha me albumin e ri "Lover". Sipas "Daily Mail" një rekord i shitjeve të këtij albumi është thyer në Kinë ku brenda një jave u shitën

më shumë se një milion kopje. Kjo shifër e shitjeve nënkupton që 29-vjeçarja është artistja më e dëgjuar ndërkombëtare në Kinë. Swift ka thënë se me këtë album është shumë e kënaqur.



Rita Ora pjesë e kampanjës së 'Rimmel'

Këngëtarja e njohur me prejardhje nga Prishtina, Rita Ora, është bërë pjesë e kampanjës më të re të kompanisë së grimit "Rimmel". Këtë herë këngëtarja ka vendosur para adhuruesve të saj të

sjell kremën për fytyrë. Rita Ora këtë lajm e ka bërë me dije me anë të një postimi në rrjetin social "Instagram". "Është shumë e bukur me shkëlqim, zgjat tërë ditën. Perfekte për jetën në rrugë", ka shkruar Ora.

Post Malone vjen me këngën "Circles"



Reper i njohur, Post Malone, ka publikuar këngën e tij më të re. "Circles" është kënga e cila brenda pak orëve mori mijëra

klikime në kanalën "Youtube". Ata që u përkujdesën për tekstin e këngës janë Austin Post, Adam Feeney, Billy Walsg, dhe Kaan Gunerberk.

Amazona?

“Më e keqja s’ka ardhur ende”

Pyjet e shiut' në Amazonë janë përfshirë nga flakët që muajin e kaluar, duke e detyruar Brazilin të shpallë gjendjen e jashtëzakonshme në rajon.

Sa zjarre janë aktive?

Në një periudhë 48-orëshe, gjatë fundjavës, pati më shumë se 2.500 zjarre aktive, raportoi BBC.

NASA ka qenë duke monitoruar zjarret. Gjatë javës së kaluar, fotot e satelitëve kanë qenë

imazhe shumë të përhapura në cdo media.

Më 20 gusht, Eric Holthaus, një meteorolog, publikoi të dhëna që tregojnë tymin nga zjarret, që mbulon rreth gjysmën e Brazilit.

Më 19 gusht, qiejt u nxinë mbi San Paulo, për më shumë se një orë, pasi një erë e fortë bëri që tymi të zhvendosej rreth 1.700 milje larg. Të Premten, Telesur TV raportoi se tymi nga zjarret mund të shihej deri në Argentinë.

dojë deri më 10 shtator, mund të sjellë lehtësim, por nuk do të ndihmojë në shuarjen e zjarrit, njoftoi Reuters të mërkurën.

Presidenti i Bolivisë Evo Morales kontrakttoi një Boeing 747 "Supertanker" javën e kaluar për të ndihmuar në shuarjen e zjarreve, njoftoi Telesur.

Gjatë fundjavës, Presidenti i Brazilit Jair Bolsonaro refuzoi 20 milion dollarë ndihmë nga udhëheqësit botërorë të G7-ës. Të mërkurën, Euronews raportoi se Peruja dhe Kolumbia bënë thirrje për një takim dhe një pakt me qëllim mbrojtjen e pyjeve.

CNN raportoi se numri i zjarreve në Brazil këtë vit është më i larti, një shifër rekord që nga 2013 dhe është rritur me 85% nga viti i kaluar. Deri më tani këtë vit janë zbuluar nga qendra e kërkimit hapësinor në Brazil, INPE, më shumë se 80,000 vatra.

Ka kaq shumë zjarr, sa që tymi është i dukshëm edhe nga hapësira. Të Hënën, Astronauti European i Agjencisë Hapësinore, Luca Parmitano, kapi imazhe nga Stacioni Ndërkombëtar Hapësinor.

Vëmendja ndaj zjarreve në atë që njihet si mushkëria e botës, u rrit në të gjithë botën javën e kaluar, kur përdoruesit e medive sociale filluan të postonin foto me disa hashtags. Njerëz anembanë globit gjithashtu dolën në rrugë në protestë, duke kërkuar që të ndërmerren



veprime për të fikur zjarret. Më pas udhëheqësit e nisën të flasin në mediat sociale dhe të hartojnë një plan për të ndihmuar në shuarjen e zjarreve.

A u ndërmer ndonjë veprim në Samitin e G7-ës?

Bolsonaro refuzoi një paketë ndihme prej 20 milion dollarësh nga vendet e G7-ës. Shefi i shtabit të Bolsonaros tha se presidenti francez Emmanuel Macron duhet të kujdeset për "shtëpinë dhe kolonitë e tij", shkruan Guardian.

Bolsonaro tha se Brazili do ta konsideronte ndihmën ndërkombëtare vetëm nëse Macron tërhiqte komentet që tingëllojnë fyese. Kryeministri Kanadez Justin


Trudeau u zotua se vendi i tij do të vazhdojë të mbështesë përpjekjet për të shpëtuar Amazonën. Ai tha të hënën se Kanadaja ofron 15 milion dollarë dhe "bomba uji" për të shuar zjarret, raporton CBC.

Çfarë po bëjnë tjetër politikanët për të dhënë ndihmën e tyre?

'Pyjet e shiut' në Amazonë janë përfshirë nga flakët që muajin e kaluar, duke e detyruar Brazilin të shpallë gjendjen e jashtëzakonshme në rajon.

Si reagoi publiku?

Tim Cook i Apple duket se është CEO i parë i një kom-



imazhe shumë të përhapura në cdo media.

Në një periudhë 48-orëshe, gjatë fundjavës, pati më shumë se 2.500 zjarre aktive, raportoi BBC.

NASA ka qenë duke monitoruar zjarret. Gjatë javës së kaluar, fotot e satelitëve kanë qenë

A janë fikur zjarret?

Zjarret janë akoma aktive. Të Shtunën, Amnesty International kapi një foto të pyjeve të djegura në shtetin Mato Grosso.

Shiu që filloi dhe pritet të vazh-





sitetin biologjik të zonës", tha Ministria e Forcës Popullore për Punët e Jashtme të Venezuelës.

#ActForTheAmazon filluan të postojnë në 'Twitter' dhe protestat nisen javën e kaluar. Në Zyrih, aktivistë të Lëvizjes Ekologjike Klimatike dhe brazilianë u mbledhën jashtë Konsullatës së Brazilit, të Premten në mëngjes. Përdoruesit e 'Twitter' kapën imazhe të një proteste në Barcelonë. Demonstrata janë zhvilluar gjithashtu në Paris, Londër, Madrid dhe Danimarkë.

Hashtagu #PrayforAmazonas u bënë trend javën e kaluar. Përdoruesit e 'Twitter' kritikuan mediat për vëmendje më të madhe ndaj zjarrit në Notre Dame dhe lajme të tjera, sesa ndaj zjarreve në 'Pyjet e Shiut. Përdoruesit e mediave sociale gjithashtu i bënë thirrje miliardërëve për mungesë dhurimesh. Leonardo di Caprio dha 5 milionë \$.

Zjarret që digjen në mbarë Amazonën çlirojnë sasi kolosale të dioksidit të karbonit në një kohë kur ekspertët thonë se botës i duhen pemët për të përthithur këtë gaz që shkakton ngrohjen e planetit. Shkencëtari i NASA-s Doug



Morton thotë se zjarret mund të përkeqësohen.

"Rajoni është vetëm në mesin e sezonit të thatë. Zjarret që fillojnë sot dhe që dalin nga kontrolli, mund të digjen për shumë javë në vazhdim", thotë zoti Morton.

Morton shton se në dallim nga zjarret që digjen në Bolivinë fqinje, zjarret e Brazilit duket se do të sjellin krijimin e hapësirave për bujqësi masive.

"Që të krijohet një tymnajë kaq e lartë që arrin në atmosferë, duhet të digjet një lloj zjarri me intensitet të lartë, lloji i zjarrit që krijohet kur u vendoset njëkohësisht mijëra hektarëve të parapërgatitur dhe të tharë nga dielli".

Presidenti brazilian Jair

Bolsonaro premtoi gjatë fushatës elektorale vendosjen e pyjeve në funksion të zhvillimit.

Mbi 160 mijë zjarre janë shfaqur këtë vit përgjatë Amazonës braziliane. Kjo shifër është nën rekordin e vendosur në vitet 2000, kur shpyllëzimi arriti kulmin.

Vendet më të industrializuara premtuan dhjetëra milionë dollarë për të luftuar zjarret.

Zoti Bolsonaro ngriti pikëpyetje rreth motivimit të tyre.

"A ndihmon ndonjëri dikë tjetër, që nuk është i varfër, pa pritur diçka në këmbim? Përse ia kanë vënë syrin Amazonës? Çfarë kanë dëshiruar prej kohësh nga ajo zonë?", u shpreh zoti Bolsonaro, shkruan VOA.

Ai shkëmbeu fjalë të ashpra me Presidentin francez Emmanuel Macron. Zoti Macron e akuzoi se po gënjen për angazhimet mjedisore. Bolsonaro thotë se Franca dëshiron ta trajtojë Brazilin si një koloni.

Një koment i tij në 'Facebook' që ofendoi bashkëshorten e zotit Macron, e nxehi situatën më tej.

"Është për të ardhur keq. Pikë së pari për të dhe për brazilianët. Mendoj se grave braziliane u vjen pa dyshim zor të lexojnë çfarë shkruan presidenti i tyre. Mendoj që brazilianët, një popull i mrekullueshëm, janë paksa të turpëruar nga sjellja e tij dhe kërkojnë që presidenti i tyre të sillet në mënyrën e duhur me të tjerët", tha zoti Macron.



panie teknologjike që përgjigjet me një ofertë për ndihmë. Cook tha në 'Twitter' se Apple do të dhuronte para, por nuk e specifikoi shumën.

Presidenti i Venezuelës, Nicolás Maduro shprehu shqetësimin për zjarret që po shkatërrojnë Brazilin dhe Bolivinë dhe ofroi ndihmë për t'i shuar ato. Kancelarja e Venezuelës gjithashtu foli për solidaritet me komunitetet autoktone në Brazil, Bolivi, Paraguai, Ekuador dhe Peru.

"Venezuela shpreh shqetësimin e saj të thellë për zjarret gjigante dhe të tmerrshme që po shkatërrojnë rajonin e Amazonës në territorin e disa vendeve të Amerikës së Jugut, me ndikime shumë serioze në popullsi, ekosisteme dhe diver-





NJIHUNI ME 10 QYTETET MË TË MIRA EUROPIANE PËR TË BËRË SHOPPING

Motori i kërkimit për shtëpitë që jepen me qira gjatë pushimeve, i cili ka analizuar të gjitha dyqanet e veshjeve dhe të këpucëve në disa prej qyteteve kryesore të Europës, duke u bazuar gjithashtu edhe tek vlerësimet që këto dyqane kanë marrë në Google ka bërë renditjen e qendrave të shoppingut.

Padyshim që kryeqytetet ndërkombëtare të modës janë Parisi, Milano, Londra dhe Nju Jorku. Por a jemi të sigurt se këto janë njëkohësisht edhe destinacionet më të mira për të bërë shopping gjatë fundjavës? Këtë përgjigje do të na e japë

Holidu, motori i kërkimit për shtëpitë që jepen me qira gjatë pushimeve, i cili ka analizuar të gjitha dyqanet e veshjeve dhe të këpucëve në disa prej qyteteve kryesore të Europës, duke u bazuar gjithashtu edhe tek vlerësimet që këto dyqane kanë marrë në Google.



Ja se cilat janë 10 më të mirat:

Zagreb, Kroaci –120 € / fundjava

Në vend të parë renditet kryeqyteti kroat, Zagrebi, si qyteti evropian më i preferuar nga të pasionuarit e shopping-ut. Ai vlerësohet me 4.35 euro në Google për një total prej 915 dyqane veshjesh dhe këpucësh, dhe është

pikërisht ky kryeqytet që vlerësohet me medaljen e arit në nivel kontinental. Rrugët më të famshme në Zagreb, të mbushura plot me dyqane veshjesh dhe këpucësh fillojnë nga rruga Tkalciceva e deri në atë Ilica (që është njëkohësisht edhe një prej rrugëve më të populluara në të gjithë Zagrebin, me rreth 6 km rrugë të mbushur me dyqane, kafe dhe restorante). Periudha më e

lartë e uljeve pritet të fillojë në 27 dhjetor.

Torino, Itali –190 € / fundjava

Me rreth 2,800 dyqane veshjesh dhe këpucësh, Torino renditet në vend të dytë me një vlerësim prej 4,29 euro në Google. Këtu uljet fillojnë në 5 janar dhe vazhdojnë deri në mesin e muajit shkurt. Disa prej rrugëve më të famshme për shopping janë rruga Roma, e cila është padyshim rruga e duhur të cilën ju duhet ta vizitoni nëse doni të bëni blerje. Pastaj duke filluar nga Porta Nuova e duke u ngjitur sipër drejt sheshit San Carlo, ju mund të gjeni të gjitha dyqanet që kërkoni, nga ato më shik e deri tek ato që kanë dizajn të më të kërkueshëm. Një këshillë tjetër: një vizitë në rrugën Po apo në rrugën Garibaldi, do të ishte perfekte për disa blerje shumë cilësore.

Vjenë, Austri – 241 € / fundjava

Medalja e bronxit i shkon kryeqytetit të Austrisë. Me mbi 3,000 dyqane stilistësh dhe markash ndërkombëtare, Vjena vlerësohet me 4,28 euro. Rruga më e



rëndësishme në Vienë për të bërë shopping është Mariahilferstraße, ku mund të gjenden dyqane nga më të ndryshmet dhe të përshtatshme për nivele të ndryshme buxhetesh.

Napoli, Itali – 170 € / fundjava

Jo vetëm pica, makarona, det, histori dhe art. Napoli me mbi 3,400 dyqane, është shndërruar gjithashtu edhe në një prej destinacioneve më të preferuara për të bërë shopping, duke u renditur në vend të katërt të kësaj liste, me një vlerësim prej 4,27 euro. Një prej rrugëve më të rëndësishme për të bërë shopping

të këtij klasifikimi dhe këtu nuk ka asgjë për t'u çuditur. Duke ecur nëpër rrugët e këtij qyteti, përveç makinave luksoze të cilat do t'ju tërheqin menjëherë vëmendjen, janë edhe vitrinat me disa prej markave më të njohura që do t'ju bëjnë gjithashtu për vete. Me mbi 2,800 dyqane, Mynihu vlerësohet me 4,27 euro. Këtu periudha e uljeve fillon nga fundi i dhjetorit. Ju mund ta filloni itinerarin tuaj të blerjeve duke u nisur nga sheshi Karlsplatz e të vazhdoni deri në Marienplatz. Një prej zonave ku ju mund të blini produkte shumë origjinale është Glockenbachvierte, ku do të gjeni dyqane me mallra unikë dhe shumë në modë.



Këln, Gjermani – 472 € / fundjava

Shopping-u në Këln të Gjermanisë nuk është aspak i lodhshëm sepse pjesa më e madhe e dyqanve ndodhen pranë njeri-tjetrit, pa qenë nevoja për të marrë mjetë të transportit publik. Me mbi 1,800 dyqane veshjesh dhe këpucësh, ky qytet renditet në vend të gjashtë të këtij klasifikimi dhe vlerësohet me 4,26 euro. Një prej rrugëve kryesore për të bërë shopping është padyshim rruga Schildergasse, njëkohësisht edhe një prej rrugëve me numrin më të

Sofja, Bullgari – 92 € / fundjava

Njësoj si Bukureshti, edhe Sofja e Bullgarisë vlerësohet me 4,26 euro për një total prej 1,600 dyqane veshjesh dhe këpucësh. Rrugët më të rëndësishme për shopping janë Vitosha Boulevard dhe Graf Ignatiev.

“Tridente”, ku më pas ju mund të vazhdoni shoppingun tuaj në një prej 3 rrugëve të tjera: Condotti, Borgognona dhe Frattina.

Milano, Itali – 354 € / fundjava

Kryeqyteti i botës por padyshim edhe një prej më të preferuarave të shopping-ut. Me mbi 5,800 dyqane, Milano vlerësohet njësoj si Roma, me 4,25 euro. Nëse vendosni të vizitoni Milanon, atëherë ju do të bënit mirë të merrni shumë ditë leje, sepse në Milano vështirë të bësh një listë me prioritete (sa i

Romë, Itali – 276€ / fundjava

Me një vlerësim prej 4,25 euro për një total prej 8,400 dyqane veshjesh dhe këpucësh, kryeqyteti i Italisë renditet në vend të nëntë të këtij klasifikimi.



Bukuresht, Rumani – 98 € / fundjava

është ajo Mille, ku ju do të gjeni marka ndërkombëtare dhe kombëtare. Më pas ju mund të vazhdoni në rrugën Gaetano Filangieri ku ndodhen edhe dyqanet super të shtrenjta dhe më pas ta përfundoni fundjavën tuaj në rrugën Chiaia, e cilësuar njëkohësisht edhe si një ndër më të mirat në botë për të bërë shopping, ku mbi të gjitha çmimet janë shumë të arsyeshme.

I cilësuar si Parisi i Lindjes, Bukureshti, nuk mund të mos ishte pjesë e këtij klasifikimi. Është vlerësuar me 4,26 euro. Periudha e uljeve këtu fillon në 15 janar dhe vazhdon deri në mars. Këtu dyqanet me më shumë shitje, janë të përqendruara në qendrat e ndryshme tregtare që ndodhen pranë qendrës së qytetit, në zonën Lipsani. Një prej rrugëve të mbushura me dyqane luksi është rruga Calea Victoriei.

Mynih, Gjermani – 534 € / fundjava

Mynihu renditet në vend të pestë



madh të dyqaneve dhe ku ju mund të gjeni të gjitha gjërat për të cilat jeni të interesuar. Më pas duke ecur përgjatë lumit Reno, ju do të shkoni në rrugën Hohestraße, e cila është gjithashtu e mbushur plot me dyqane me marka cilësore.

Edhe nëse jeni të interesuar për marka jo shumë të shtrenjta apo edhe për ato më luksozet, atëherë ju duhet të vishni paraprakisht atlete shumë të rehatshme sepse Roma ka shumë për të ofruar. Duke u nisur nga rruga Corso dhe duke shkuar në fund del në të famshin

takon dyqanve të veshjeve dhe këpucëve). Por disa prej më të rëndësishmeve dhe më të famshmeve janë Quadrilatero della Moda, Galleria Vittorio Emanuele II, Corso Vittorio Emanuele II dhe Corso Buenos Aires. Monitor



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

Kampionia dhe nënkampionia kërkojnë fitore në derbi

Kampioni dhe nënkampionia në fuqi e ndajnë meqandërsisht sot (e shtunë) në Drenas. Feronikeli ka paralajmëruar se do t'u rikthehet fitoreve në këtë ndeshje derbi, por edhe Prishtina ka ambicie të rikthehet në kryeqytet me pikët maksimale



raste të shumta, keq që nuk i shfrytëzuar, por kjo nuk mund ndodh gjithmonë dhe rastet kur topi nuk hyn në portë, nuk ndodh shpesh. Kjo na jep optimizëm, sepse do të ishte krejtësisht ndryshe sikur mos të krijonim, sidomos nga loja që e praktikojmë apo e stërvitim. Pra, besoj shumë se nga ndeshja e ardhshme dhe nga ndeshja në ndeshje do të jemi edhe më të përqendruar para portës duke rritur më shumë përqindjen e konkretizimit të golave", ka deklaruar Januzi.

Dukagjini pëson debakël nga Drita

Ish-kampionia e Kosovës në futboll, Drita e treguar formë të lartë edhe në ndeshjen e dytë radhazi në IPKO Superligën e Kosovës në futboll. Pas fitores ndaj Flamurtarit (3-0), Drita e mposhti edhe skuadrën e Dukagjinit me rezultat bindës 0 me 4. Serinë e golave në ndeshjen e parë të javës së tretë e hapi Xhevdet Shabani, i cili realizoi pas nëntë minutave lojë. Dy minuta para përfundimit të pjesës së parë, Bunjamin

IPKO SUPERLIGA

Dukagjini - Drita 0-4

Të shtunën takohen:
16:00 Feronikeli - Prishtina
16:00 Llapi - Ballkani
16:00 Flamurtari - Ferizaj

Të dielën takohen:
16:00 Trepça '89 - Drenica
16:00 Gjilani - Vushtrria

LIGA E PARË

Të shtunën takohen:
Istogu - Onix
Liria - KEK-u
Arbëria - Ramiz Sadiku
Vitia - Besa

Të dielën takohen:
Vllaznia (P) - Malisheva
Vëllaznimi - Drenasi
Dardana - 2 Korriku
Trepça - Ulpiana (shtyhet)
(Të gjitha ndeshjet zhvillohen nga ora 16:00)

Shabani e dyfishoi epërsinë e mysafirëve. Xhevdet Shabani konfirmoi në pjesën e dytë së është lojtari kryesor i Dritës, pasi shënoi golin e dytë personal dhe të tretin për skuadrën nga Gjilani, kurse rezultatit final e vulosi Betim Haxhimusa në minutat shtesë.

EPOKA ERE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 30 GUSHT - Derbi i javës së tretë në IPKO Superligë zhvillohet sot (e shtunë) dhe përballen kampioni në fuqi, Feronikeli dhe nënkampionia, Prishtina. Sulmuesi me përvojë të madhe, Astrit Fazliu, ka bërë me dije për gazetë se pas humbjes nga Ballkani në xhiron e kaluar, "Nikli" synon fitore në këtë ndeshje derbi. "Në fundjavë na pret një ndeshje e vështirë ndaj Prishtinës dhe normalisht se përgjigja më e mirë për humbjen në ndeshjen e fundit është fitorja në këtë derbi. Tri pikët nuk do të jenë të lehta për faktin se Prishtina ka skuadër të mirë, por angazhimi nuk do të mungojë për fitore", ka thënë Fazliu, i cili rikthehet pas mungesës në ndeshjen e kaluar.

Optimist për fitore është shprehur edhe sulmuesi i Prishtinës, Ahmed Januzi, i cili ka thënë për faqen zyrtare të klubit se skuadra "bardhekaltër" nuk ia ka frikën Feronikelit dhe asnjë skuadre tjetër. "Jemi stërvitur këto ditë me përqendrim maksimal duke dashur t'i eliminojmë gabimet që i kemi bërë edhe me Flamurtarin dhe po shpresoj që për të shtunën do të jemi gati. Normalisht, përball do të kemi një kundërshtar shumë të fortë, por nuk i frikësohemi as Feronikelit dhe asnjë skuadre tjetër. Ne jemi vetë pretendentë dhe udhëtojmë për pikë maksimale, por normalisht gjithmonë duke ia lënë fushës", ka thënë Januzi, i cili është rikthyer te Prishtina pas një viti që kaloi në skuadrën e Llapi. "Megjithatë nuk fituam ndaj Flamurtarit, shenjë e mirë ishin se kishim

Challandesi publikon listën, mungojnë 5 yje

PRISHTINË, 30 QERSHOR - Përzgjedhësi i Përfaqësueses së Kosovës, Bernard Challandes, e ka publikuar listën e futbollistëve të cilët do t'i ketë në dispozicion për dy ndeshjet e radhës në kuadër të kualifikimeve për "Euro 2020". Kosova përballlet me Republikën e Çekisë, më 7 shtator në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë dhe me Anglinë, më 10 shtator në "St. Mary's Stadium" në Southampton. Stërvitja e parë e "Dardanëve" është më 2 shtator, në orën 18:00, në stadiumin "Fadil Vokrri". "Dardanët" do të kenë



plot pesë mungesa të rëndësishme për dy ndeshje, pasi janë të lënduar Milot Rashica, Herolind Shala, Benjamin Kololli, Arbër Zeneli dhe Hekuran Kryeziu. Në përfaqësuese janë rikthyer Valon Berisha dhe Bernard Berisha, kurse pjesë e kësaj liste janë edhe Ibrahim Dresheviq dhe Florent Muslija.

LITSA E FUTBOLLISTËVE

Samir Ujkani, Arjanet Muriq, Visar Bekaj, Mërgim Vojvoda, Florent Hadergjonaj, Leart Paqarada, Ibrahim Dresheviq, Mirlind Kryeziu, Idriz Voca, Anel Rashkaj, Besar Halimi, Valon Berisha, Bersant Celina, Florent Hasani, Edon Zhegrova, Florent Muslija, Elbasan Rashani, Bernard Berisha, Vedat Muriqi, Atdhe Nuhiu.

Loriana ia sjell Kosovës medaljen e tretë të bronzit

PRISHTINË, 30 GUSHT - Kosova e ka fituar edhe medaljen e tretë të bronzit në kampionatin botëror të xhudos, i cili po mbahet në Tokio të Japonisë. Pas Distria Krasniqit dhe Majlinda Kelmendit, triumfuese doli edhe Loriana Kuka. Loriana shënoi katër fitore, ndërsa në luftën për të bronzit mundi sllovenen Klara Apotekar me Ippon. Kosova me këtë medalje renditet e treta në botë, për numrin e medaljeve të fituara. Pas këtij suksesi ka reaguar edhe trajneri Driton Kuka, i cili shprehet shumë i lumtur me tri medaljet e fituara në Kampionatin Botëror. "Tokio sivjet po më çmend! Tri medalje në Kampionat Botëror! Po duket si ëndërr. Çfarë ndjenja po më sjell Lori sivjet. Medalja nga Kampionati Botëror për Kosovën për popullin shqiptar por... Familja është ajo e shenjta për mua dhe besoj për çdo shqiptar. Medalja Botërore edhe në familjen Kuka! Sa shumë jam



krenar sot edhe si trajner, por edhe si axhë i Lorianës! Kosova mbi të gjitha", ka shkruar Kuka në "Facebook".

Nadali kualifikohet pa luajtur, fitojnë Zverev e Kyrgios

NJU JORK, 30 GUSHT - Rafael Nadali avancon në raundin e tretë të US Open pa luajtur. Rivali i tij, Thanasi Kokkinakis, është tërhequr për shkak të një dëmtimi, duke ia bërë më të lehtë

rrugëtimin në këtë turne tenistit spanjoll. Nuk zhgënjën australiani Nick Kyrgios, që mundi 3-0 (6-4, 6-2, 6-4) francezin Antoine Hoang, duke avancuar në raundin e tretë. Një biletë për më tej

siguron edhe tenisti kroat Marin Ciliq, që mundi 3-1 me përmbysje (4-6, 6-3, 7-5, 6-3) gjermanin Marcel Stebe, ndërsa Alexander Zverev fitoi me vështirësi 3-2 ndaj amerikanit Frances

Tiafoe. Fiton edhe zvicerani Stansislav Wawrinka, që mundi 3-1 francezin Jeremy Chardy, ndërsa rusi Daniil Medvedev eliminoi bolivianin Hugo Dellien, duke fituar 3-1.



Short i lehtë për Unitedin dhe Arsenalin

MONACO, 30 GUSHT - Në Grimaldi Forum të Montecarlos u hodh shorti i fazës së grupeve të edicionit 2019-2020 të Ligës së Evropës. Grupe deri diku të balancuara për numrin më të madh të skuadrave, ndërkohë që nuk pritët të hasin vështirësi për t'u kualifikuar në raundin tjetër klubet favorite për suksesin final si Arsenali, Manchester Unitedi, Roma, Lazio e Sevilla. Skuadra më e titulluar në këtë kompeticion, Sevilla, u shortua në Grupin A bashkë me Apoel Nicosian, Qarabag dhe Dudelange që do të rivalizojnë mes tyre për vendin e dytë. Në Grupin B do t'i masin forcat me njëra-tjetrën, Dinamo e Kievit, FC Copenhagen, Malmo dhe Lugano. Një nga më interesantët dhe me rezultate që mund të jenë të paparashikueshme mund të jetë Grupi C, ku bëjnë pjesë Basel, Krasnodar, Getafe e Trabzonspor. Në Grupin D, Sportingu i Lisbonës dhe PSV Eindhoven pritet ta kenë të thjeshtë ndaj Rosenborg dhe Lask çështjen e kualifikimit. Lazio në Grupin E nuk do ta ketë aspak të thjeshtë ndaj Celticit dhe Rennesit, ndërkohë që rumunët e Clujit kanë pak shanse për kualifikimin. Në Grupin F, Arsenali do të përballet me Frankfurтин, por edhe Standart e Liezhit dhe Vitoria Guimaraes. Interesant dhe i rivalizuar pritet të jetë dhe Grupi G, aty ku bëjnë pjesë Porto, Young Boys, Feyenoord dhe Rangers. Në Grupin H Cska e Moskës do të përballet me Ludogorets, Espanyol dhe Ferencvaros. Grupi I ndërkohë përbëhet nga Wolfsburg, Gent, Saint Etienne dhe ukrainasit e Oleksandryas. Në grupin J, Roma do t'i sfidojë gjermanët e Borussia

DRAW RESULT		GROUP STAGE DRAW	
	SEVILLA FC	FC DYNAMO KYIV	
A	APOEL FC	FC KØBENHAVN	B
	QARABAG FK	MALMØ FF	
	F91 DUDELANGE	FC LUGANO	
	FC BASEL 1893	SPORTING CP	
C	FC KRASNODAR	PSV EINDHOVEN	D
	GETAFE CF	ROSENBERG BK	
	TRABZONSPOR AS	LASK	
	S.S. LAZIO	ARSENAL FC	
E	CELTIC FC	EINTRACHT FRANKFURT	F
	STADE RENNAIS FC	R. STANDARD DE LIÈGE	
	CFR 1907 CLUJ	VITÓRIA SC	

DRAW RESULT		GROUP STAGE DRAW	
	FC PORTO	PFC CSKA MOSKVA	
G	BSC YOUNG BOYS	PFC LUDOGORETS 1945	H
	FEYENOORD	RCD ESPANYOL	
	RANGERS FC	FERENCVÁROSI TC	
	VIL WOLFSBURG	AS ROMA	
I	KAA GENT	B. MÖNCHENGLADBACH	J
	AS SAINT-ÉTIENNE	ISTANBUL BASAKSEHIR FK	
	FC OLEXANDRIYA	WOLFSBERGER AC	
	BESIKTAS JK	MANCHESTER UNITED FC	
K	SC BRAGA	FC ASTANA	L
	WOLVERHAMPTON WANDERERS FC	FK PARTIZAN	
	ŠK SLOVAN BRATISLAVA	AZ ALKMAAR	

Moenchengladbachut, turqit e Istanbul Basaksehirit dhe austriakët e Wolfsbergerit. Një grup i balancuar mund të konsiderohet edhe ai K, me Besiktasin, Bragën, Wolverhampton

dhe Slovan Bratislavën, ndërsa grupi i fundit, ai L, përbëhet nga Manchester Unitedi, Astana, Partizani i Beogradit dhe AZ Alkmaar.

Halepi eliminohet nga US Open

NJU JORK, 30 GUSHT - Simona Halepi ka thënë "lamtumirë" grand slam të US Open. Tenistja rumune, fituese e Wimbledonit, u mund 2-1 (2-6, 6-3, 7-6) nga tenistja amerikane Taylor Townsend. Halepi e nisi mirë ndeshjen, duke fituar setin e parë, por më pas niveli i saj ra. Duket se ajo e nënvlerësoi rivalen, që përmbysi shifrat dhe fitoi setin e tretë në "tie break". Në raundin e tretë avancon tenistja japoneze Naomi Osaka, kampionja në fuqi e US Open, e cila mundi 2-0 (6-2, 6-4) Magda Linette. Më tej avancon edhe vogëlushja amerikane Cori Gauff, 15 vjeçe, që mundi 2-1 hungarezin Timea Babos (6-2, 4-6, 6-4), duke



shkuar në raundin e tretë. Nuk zhgënjën tenistja daneze Carolien Wozniacki që, falë fitores 2-1 ndaj amerikanes Danielle Collins, avancon në raundin e tretë. Një

biletë për më tej kanë siguruar edhe tenistja britanike Johanna Konta (2-0 ndaj Margarita Gasparyan) e belgja Elise Mertens (2-0 ndaj Krystina Pliskova).

SHKURT

Tmusiqi vazhdon me Prishtinën

Një ndër basketbollistët më të mirë në Superligën e Kosovës në basketboll, Mikaile Tmusiq, e ka vazhduar kontratën me Prishtinën. Mikaile njihet si lojtar mjaft i rëndësishëm për ekipin kryeqytetas, sepse është i fuqishëm në mbrojtje, kurse në sulm treshet janë pika më e fortë e tij. Ai ishte një ndër pikat më të forta të skuadrës në edicionin e kaluar ku Prishtina bëri histori në arenën evropiane. Prishtinasit janë në kompletim e sipër të ekipit dhe në sezonin e ardhshëm synojnë të jenë të suksesshëm si në rrafshin vendor, po ashtu edhe në atë ndërkombëtar. Përkundër largimit të papritur të kryetarit të klubit, Blerand Stavileci, Prishtina po e vazhdon rrugën e suksesit.

Hazardi, lojtar i vitit në Ligën e Evropës

Ylli i ri i Real Madridit, Eden Hazard, është shpallur lojtar më i mirë i edicionit të kaluar në Ligën e Evropës. Ai është transferuar në afatin kalimtar të verës nga Chelsea në Real Madrid, kurse në konkurrencë për këtë çmim e kishte ish-shokun e skuadrës, Oliver Giroud dhe Luka Joviqin. Hazardi nuk ishte i pranishëm në ceremoninë e hedhjes së shortit për sezonin 2019-2020 të Ligës së Evropës, por falënderoi organizatorët për çmimin nëpërmjet një video.

Ronaldo beson se Juve mund ta fitojë Ligën e Kampionëve

Cristiano Ronaldo ka besim të madh në aftësinë e Juventusit për t'i dhënë fund pritjes së gjatë për lavdërinë në Ligën e Kampionëve. "Zonja e Vjetër" nuk ka arritur të fitojë në Ligën e Kampionëve që nga viti 1996, duke humbur pesë finale. "Shorti është i vështirë, por gjithmonë është. Kam besim të madh në ekipin tim dhe nuk mund të pres që të luaj në këtë edicion të mirë të Ligës së Kampionëve. Ka shumë ekipe që mund ta fitojnë trofeun dhe gjithmonë është e vështirë, por unë jam pozitiv dhe i sigurt", ka thënë Ronaldo.

Kahni, president i Bayernit në vitin 2022

Oliver Kahn do të jetë presidenti i Bayern Munchenit, por nga viti 2022 për shkak se tani do të jetë pjesë e stafit drejtues. 11 vjet pasi u tërhoq nga futbolli, Oliver Kahn është gati të kthehet në ekipin që e bëri atë një nga portierët më të mirë të të gjitha kohëve. 50-vjeçari do të kthehet si pjesë e stafit drejtues nga janari i vitit të ardhshëm dhe në vitin 2022 do ta marrë postin e presidentit të klubit gjerman. "Është një nder i madh për mua të bashkohem me bordin drejtues të klubit dhe më pas të bëhem president. Falënderoj Uli Hënes për besimin! Unë jam i lidhur me këtë klub që ka formuar jetën time", ka thënë Kahn.

Evra: Pogba nuk largohet nga Unitedi

Ish-futbollisti i Manchester Unitedit, Patrice Evra, ka thënë se Paul Pogba nuk do të largohet "Old Trafford". "Paul është i fokusuar, është në Manchester dhe do të qëndrojë. Ka pasur bisedime, është mirë për klubin dhe për të. Do të shohim pas disa vjetëve, por tash do të jetë e vështirë për të nëse largohet. Pauli është vëllai im, nëse nuk është i lumtur, i them të largohet, por do të doja që të qëndrojë", ka thënë Evra.



Form. MAP- SHCK-02
Obraz. MJU-CSK-02

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës
Agencija sa Upravljanje Memorialni Kompleksa Kosova
Agency on Management of Memorial of the Complexes of Kosovo



SHPALLJE E REKRUTIMIT / OGLAS ZA REGRUTACIJU

Institucioni / AGJENCIA PËR MENAXHIMIN E KOMPLEKSEVE MEMORIALE TË KOSOVËS (AMKMK), kërkon të punësojë në AMKMK.
Institucija AGENCIJA SA UPRAVLANJE MEMORIALNI KOMPLEKSA KOSOVA-(AUMKK) nastoji da zaposli u AUMKK.

Titulli i vendit të punës / Naziv radnog mesta:

- Zyrtar për Ndërtimtar - UNM/110 / JP00040405 (1 pozitë)
- Službenik za građevinarstvo - UNM / 110 / JP00040405 (1 položaj)

Departamenti/Divizioni:

- Departamenti për Planifikim, Projekte dhe Menaxhim/Divizioni për Planifikim, Projekte të Komplekseve
- Odjel za planiranje, projekte i upravljanje/Odjel za planiranje, složene projekte

Kategoria funksionale dhe grada e vendit të punës/Funksionalna kategorija i stepen radnog mesta:

- Niveli profesional, koeficienti i pagës 7 / Struka Profesionalna, koeficijent plate 7

Numri i referencës së vendit të punës/ Broj preporuke za radno mesto: RN00005493

Detyrat dhe përgjegjësitë / Poslovi i odgovornosti:

- Harton dhe zhvillim planet e punës në pajtim me mbikëqyrësin për zbatimin e detyrave të përcaktuara në bazë të objektivave të njësisë dhe jep rekomandime lidhur me realizimin e këtyre objektivave;
- Analizon dhe vlerëson proceset dhe procedurat brendshme dhe rekomandon ndryshime dhe përmirësime me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe cilësisë së punës;
- Harton procedurat dhe ndihmon zyrtarët në lëshimin e lejeve ndërtimore dhe përcaktimin e kushteve urbanistike për zbatimin e planit urbanistik, planit të rregullimit, planit të parcelimit, vijës së rregullimit dhe ndërtimit;
- Mbikëqyrë zbatimin e legjislacionit, procedurave dhe standardeve lidhur me ndërtimet si dhe siguron zbatimin e programit për rregullimin e tokës ndërtimore;
- Organizon dhe merr pjesë në komisionin për pranime teknike të objekteve ndërtimore dhe shërbimeve tjera përkatëse;
- Këshillosh për sigurimin e dokumentacionit të nevojshme për kryerjen e ndërtimit dhe banimit;
- Siguron mbajtjen e rregullt të protokolleve të ndërtimit dhe në raste të caktuara del në terren për shikim dhe incizim të gjendjes faktike;
- Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi;
- Izrahuje i razvija planove rada u skladu sa supervizorom za sprovođenje zadataka dodeljenih ciljevima jedinice i daje preporuke u pogledu postizanja tih ciljeva;
- Analizira i ocenjuje interne procese i postupke i preporučuje izmene i unapredenja u cilju povećanja efikasnosti i kvaliteta rada;
- Razvija procedure i pomaže službenicima u izdavanju građevinskih dozvola i utvrđivanju urbanističkih uslova za sprovođenje urbanističkog plana, regulacionog plana, plana parcela, regulacione linije i izgradnje;
- Nadgleda sprovođenje građevinskog zakonodavstva, procedura i standarda i osigurava sprovođenje programa uređenja građevinskog zemljišta;
- organizuje i učestvuje u komisiji za tehnički prijem gradilišta i drugih srodnih usluga;
- savetuje za obezbeđivanje dokumentacije potrebne za izgradnju i okupaciju;
- obezbeđuje redovno održavanje protokola za izgradnju i u određenim slučajevima izlazi da se pregleda i zabeleži stvarno stanje;
- obavlja i druge dužnosti u skladu sa zakonima i drugim propisima koje Supervizor može s vremena na vreme tražiti;

Shkollimi i kërkuar / Obrazovanje koji se zahteva:

- Diplomë Universitare - Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës, Inxhinieri Ndërtimore;
- Univerziteteska Diploma - Građevinski i arhitektonski fakultet, Građevinski inženjering;

Aftësitë, përvoja dhe atributet e tjera që kërkohen / Veštine, iskustvo i druge osobine koje se zahtevaju.

- Minimum dy (2) vite përvojë profesionale;
- Të ketë njohuri në legjislacionin dhe politikën vendore dhe standardet në lëmin ndërtimore
- Shkathësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit, shkathësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi për përbushje të detyrave dhe punëve nën presion;
- Shkathësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point, Access);
- Minimalno dve (2) godine profesionalnog iskustva;
- Poznavanje lokalnog zakonodavstva, politika i standarda u oblasti građevine;
- Veštine u komunikaciji, planiranju rada i vodenju tima, istraživačkim, analitičkim, evaluacionim veštinama I formulisanju preporuka i profesionalnih saveta;
- Sposobnost izvršavanja zadataka i zadataka pod pritiskom;
- Kompjuterska pismenost u softverskim aplikacijama (Vord, Ekcel, Pover Point, Access);

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim / Uslovi za učešće na regrutaciji/

1. Në Shërbimin Civil kanë të drejtë të punësohen shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore, të cilët kanë zotësi të plotë të veprojne, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave ekzekutive, drejtuese ose zbatimin e funksioneve administrative, si dhe kanë aftësitë fizike, që kërkohen për pozitën përkatëse. /

1. U Civilnoj službi ima pravo zaposlenja državljani Republike Kosovo punoletni koji imaju punu sposobnost obavljanja poslova, koji su u posedovanju civilnih i političkih prava, koji imaju potrebnu školsku spremu i stručnu sposobnost za obavljanje zadataka u ekzekutivu, upravljanju ili sprovođenju administrativnih funkcija, oni koji imaju psiho-fizičku sposobnost koja su potrebna za obavljanje dotičnih zadataka.

- Pranimi në Shërbimin Civil të Kosovës mund të bëhet deri në një (1) vit para moshës së pensionimit. /
- Prijem u Civilnoj službi Kosova može se izvršiti do jedne (1) godine pre penzionisanja.

Procedurat e konkurrimit / Postupak konkurisanja/

Procedura e konkurrimit është e hapur për kandidatë të jashtëm dhe për nëpunës civilë ekzistues / Procedura konkurisanja je otvorena za spoljne kandidate kao i za postojeće civilne službenike

Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin / Zakonski i podzakonski akti koji regulišu zaposljavaње: Përzgjedhja bëhet në pajtim me Ligjin nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregulloren nr. 02/2010 për procedurat e rekrutimit në Shërbimin Civil dhe akteve tjera Ligjore dhe nënligjore që vijnë pas tyre/ Izbor se vrši u skladu sa Zakonom br. 03 / L-149 o državnoj službi Republike Kosovo i Uredba br. 02/2010 o postupcima zaposljavaња u državnoj službi i drugim zakonodavnim aktima

Kohëzgjatja e emërimit / Vremenski rok imenovanja:

Me afat të pacaktuar - e përhershme (e karrierës) / Na neodređeno vreme - stalna (karijere)

Afati i konkursit / rok konkursa

Afati i konkursit është 15 ditë kalendarike, nga data e shpalljes në mjetet e informimit publik. / Rok za konkurisanje je 15 kalendarskih dana objavljivanja u sredstvima javnog informisanja.

Data e mbylljes së konkursit / Krajni rok konkursa: 14/09/2019

Paraqitja e kërkesave / Prijava zahteva-Podnošenje zahteva: /

Aplikacionet merren dhe dorëzohen / Aplikacija se uzima i dostavlja:

Rr."Zenel Salihu", objekti i ish-Gjykatës Themelore të Prishtinës, kati i II-të, zyra nr. 204, Divizioni për Burime Njerëzore, Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale ose mund të shkarkohen në ueb-faqen <https://amkmk.rks-gov.net>, Ul. "Zenel Salihu", bivša zgrada Osnovnog Suda u Pristini, sprat II, kancelarija br.204, Odsek za Ljudske Resurse, Agencija sa Upravljanje Memorialni Kompleksa Kosova ili se može preuzeti sa ueb-stranice <https://amkmk.rks-gov.net>

Kërkesat specifike / Specifični zahtevi: Nuk ka/Ne

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit:

- Dëshminë e kualifikimit shkollor (diplomat jashtë vendit duhet të jenë të nostrifikuara nga MASHT-i);
- Dëshmi për përvojën e punës;
- Dy rekomandime (nëse kenë);
- Kopjet e dy raporteve të fundit, të njëpasnjëshme, të vlerësimit të punës (nëse ekzistojnë të tilla);
- Dokumenti i identifikimit;

Uz Zahtev (Aplikaciju) treba dostaviti kopiju dokumenata:

- Dokaz o obrazovnim kvalifikacijama (diplome stečene u inostranstvu moraju se proveriti u MPN1);
- Dokaz o random iskustvu;
- Dve - Preporuke (ukoliko ih imate);
- Kopija dve zadnje uzastopne procene posla (ako ista postoje);
- Dokument identifikacije;

"Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe asaj femërore, nga të gjitha komunitetet në Kosovë" / "Kosovska javnana služba je u službi svih ljudi na Kosovu, i prima aplikacije muškaraca i žena iz svih Kosovskih zajednica".

"Komunitetet joshumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e Shërbimit Civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në nenin 11, paragrafin 3, të Ligjit nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës". / "Manjinske zajednice i njihovi pripadnici imaju pravo da budu predstavljeni proporcionalno u organima Javne službe na lokalnom i centralnom nivou, kao što je naznačeno u Čl. 11, paragraf 3 Zakona Br.03/L-149 o Javnoj Službi Republike Kosova".

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijn brenda 5 ditësh, aplikacionet që arrijn pas këtij afati nuk do të shqyrtohen fare/ Poštanske pošiljke s poštanskim žigom na pošiljci napravljenim posljednjeg dana roka za prijavu smatrat se se važećim i smatrat se se ako dostignu u roku od 5 dana, a prijave koje stignu nakon ovog uopšte neće biti razmatrano.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen/ Dostavljenog roka se ne primaju, isto i nkompletirane aplikacije.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër do të kontaktohen/ Samo izabrani kandidati užeg kruga u spisku treba da se kontaktiraju.

Emri, mbiemri dhe numri i telefonit të personit që mund të kontaktohet në rast të ndonjë pyetjeje: Ime, prezime i broj telefona osobe koju treba kontaktirati u slučaju bilo kakvih nedoumica:

Divizioni për Burime Njerëzore/Rukovodiod Odsaka za Ljudske Resurse, tel: 038-200-10-804

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898
Sallon Depilimi Lume's Details
lumesdetails
Mbrapa Teatrit, 4 Shullat, Rr. Bajram Kelmendi



Në bazë të nenit 21 të Ligjit për Ndërmarrje Publike Nr. 03/L-087 i ndryshuar dhe i plotsuar me Ligjin 04/L-111 harmoni me Kodin të Etikës dhe Qeverisja Korporative për Ndërmarrjet Publike dhe nenit 21.3.6 të Statutit të KRM "UNITETI" SHA-Mitrovicë, Bordi i Drejtorëve në takimin e rregullt me datë 26.07.2019 vendosi që me datë 06.08.2019 të shpall këtë:

KONKURS

Pozita: Sekretar i KRM "UNITETI" Sh.a.
I përgjigjet: Bordit të Drejtorëve-Drejtorit Ekzekutiv
Vendi: Mitrovicë

Kushtet dhe kualifikimet e kërkuara:

- Të ketë diplomën Univerzitare të Fakultetit Juridik të sistemit 4 vjeçar ose Master
- Të ketë së paku 3 vite përvojë në profesion
- Të ketë integritet të lartë moral dhe profesional
- Të ketë aftësi të dëshmuara në menaxhim
- Të ketë njohuri të mira të punës me kompjuter (Microsoft, Word, Excel etj.)
- Preferohet njohja e Gjuhës Angleze
- Vërtetimin nga Gjykata që nuk është nën hetime
- Të jetë komunikativ dhe të ketë aftësi organizative dhe menaxheriale

Detyrat dhe përgjegjësit kryesore:

- Do të mbajë regjistrin e akcionarëve.
- Veproj si agjent i Kompanisë për pranimin e njoftimeve.
- Të bëjë të gjitha arkivimet e nevojshme, publikimet dhe njoftimet me autoritet e duhura që kërkohet me ligj dhe me akte nënligjore.
- Të mbikqyrë mirmbajtjen e duhur dhe azhurimin e rregullt të ueb faqes të parashikuar me seksionin VIII(6)
- Të koordinojë me KSHE-në pregaditjen e shkresave për mbledhjet të Bordit të Drejtorëve dhe Komitetit për Auditim (Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga kryesuesi i tyre) si dhe do të shenojë ato në librin e procesverbaleve. Procesverbali duhet të përmbajë informatat në vijim: emrat e të pranishëmve, vendin dhe datën mbledhjes, çështjet kryesore që ngrihen gjatë diskutimit të pikave individuale të rendit të ditës, tekstin e vendimit të propozuar rezultatin e votimit dhe votat e dhëna nga secili individ, tekstin e saktë të vendimeve të miratuara si dhe çfarëdo kundërshtimi të bërë lidhur me ato vendime.
- Procesverbali i mbledhjes së kuvendit të nënshkruar nga kryesuesi i Kuvendit dhe Sekretari dhe dorzohet për tu miratu në mbledhjen e ardhshme të Kuvendit
- Procesverbali i secilës mbledhje të Bordit të Drejtorëve duhet të dorzohet për aprovim në mbledhjen e ardhshme të Bordit të Drejtorëve dhe duhet të nënshkruhet nga Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve dhe Sekretarit.

Procedura e aplikimit:

- Aplikacionit duhet bashkëgjitur edhe këto dokumente:
- CV-ja (Biografia),
- Kopja e letër njoftimit,
- Letër motivimi,
- Deklarata nën betim
- Diplomën e fakultetit - kopje,
- Dëshmitë e përvojës paraprake të punës,
- Dëshminë se nuk jeni nën hetime, jo më të vjetër se 3 muaj.
- Programi zhvillimor për kompaninë

Dorëzimi i kërkesës dhe dokumentacionit përkatës bëhet tek Zyra e Arkivës Konkursi zgjatë 21 ditë. Dorëzimi i dokumentave fillon nga data 06.08.2019 dhe përfundon në ora 16.00 të datës 27.08.2019.

Kërkesat e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuar me dokumentacione përkatëse, nuk do të merren për shqyrtim nga ana e Bordit Drejtorëve. Vlerësimi formal dhe intervista do të bëhen pas përfundimit të afatit për aplikim, ndërsa NP mban të drejtën e formimit të listës së shkurtër me aplikant.

Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letër Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook www.facebook.com/gieipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► **Banesë me qira në Dardani për çif bashkëshortësh. Banesa ka 50 m2 me një dhomë gjumi, sallon e kuzhinë, banjo e ballkon dhe shpajz. Kati i 7 me lift. Çmimi 250 €uro kontakti 044-171328.**

► "G-Goat Group" SH.P.K. shpallë të pavlefshme certifikatën e regjistrimit të biznesit me nr. 810098170.

► Pllana Pharm shpallë certifikatën e TVSH-së, me nr. 330393661 dhe me nr fis. 810135500.

► Arbona Zenullahu shpallë të pavlefshëm INDEX-in, e Kolegjit "Dardania" Prishtinë.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokal në qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Shitet banesa në Lakërishte përballë Procredit Bankës, hyrja e parë kati i 9 banesa ka 50m2 me dokumentacion të rregullt, çmimi 52 000€. Për info 044/672-439.

► Lëshohet me qira banesa në lakërishte afër Procredit bankës është e mobiluar 50m2 për një çift çmimi është 220€. Për irro 044/672-439.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

► Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

► Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.

► Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo, ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet. Për info: 045/699-221.

► Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qërimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.

► Lëshohet banesa me qira në Prishtinë në lagjen "Ulpiana", afër AAK-së. Për informata lajmërohuni në tel: 044/162-783

► Lëshoj banesë me qira në Ulpianë, tek Fontana në: E 30-3A, nr.27, kati -IV-. Çmimi sipas marrëveshjes në info: 044-132-368.

► Kërkoj dy bashkëbanuese, mundësisht të cilat janë duke punuar. Banesa gjendet në qendër të qytetit në Prishtinë përball Prokurorisë së shtetit (ish-ndërtesa e OSBE-së, ose ish-ndërtesa e Bankës së Lubjanës), rruga "Hajdar Dushi", afër shtabit kryesor të Policisë së Kosovës. Banesën mund ta shihni çdo ditë. Numri i telefonit: 049/402-518.



Shpall konkurs për pranimin e fëmijëve të moshave të ndryshme (0,9 - 6 vjeç)

Aplikimi për regjistrim të fëmijëve fillon nga data:
10.08.2019 deri 30.08.2019

Për çdo informatë shtesë mund të drejtoheni përmes telefonit 045 714 713.

